



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 269

Tiranë – E mërkurë, 18 janar 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 80, datë 30.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 316, datë 29.5.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 27613
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 81, datë 30.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 497, datë 31.1.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1583, datë 20.6.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-3420, datë 25.11.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 27615
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 82, datë 30.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-2211 (258), datë 3.4.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 27620
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 83, datë 30.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-1217 (147), datë 13.7.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 27625
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 84, datë 30.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 10, datë 26.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; nr. 168, datë 27.11.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 447, datë 5.3.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 27630
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 85, datë 30.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-288, datë 16.1.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 27635

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 86, datë 30.12.2016	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”; - Pezullimin e zbatimit të pikës 9, të kreut II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” deri në përfundim të gjykimit.....	27641
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 87, datë 30.12.2016	Me objekt shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-3939 (462), datë 23.9.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	27651
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 88, datë 30.12.2016	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 485, datë 4.6.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 816, datë 18.3.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2016-916, datë 7.4.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi); - Pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të mësipërme.....	27657
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 89, datë 30.12.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1/154 akti, datë 10.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.....	27660



VENDIM
Nr. 80, datë 30.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 1.12.2016
mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen
nr. 55 Akti, që i përket:

KËRKUES: Sabri Sulçe

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Islam
Gjevori, Tefta Sulçe, Marsel Sulçe

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me
Kushtetutën i vendimit nr. 316, datë 29.5.2014 të
Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4/1, 5, 42, 131/f,
134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës
së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Evropiane për
të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha,
mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të
kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës,
prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar,
Islam Gjevori, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe
diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi gjatë procesit të privatizimit në vitin
1991 ka lidhur dy kontrata shitblerjeje me seksionin
e financës së Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Korçë
për blerjen e truallit të fabrikës së bukës në Korçë
të përbërë nga furra nr. 1 elektrike, me sipërfaqe
360 m² dhe furra nr. 2 me solar, me sipërfaqe të
përgjithshme 793 m². Kontratat janë regjistruar
pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme Korçë (në vijim “ZRPP-ja Korçë”).

2. Në datën 27.8.1992, kërkuesi i ka shitur
furrën nr. 2 me solar subjektit të interesuar Islam
Gjevori, kurse në datën 5.9.1992 ata kanë

nënshkruar edhe një deklaratë noteriale, ku,
midis të tjerash, përcaktohet se “*pala shitëse Sabri
Sulçe deklaroi se i ka shitur palës blerëse një furrë buke
solar, të cilësuar furra nr. 2 në adresën dhe kufizimet e
lartpërmendura. Pala shitëse deklaroi gjithashtu se
megjithëse në kontratën e shitjes nr. 737 kol, nr. 1134
rep., datë 20.9.1991 nuk specifikohet nëse i ka kaluar
në pronësi toka, ai e ka blerë edhe atë, dhe po kështu e
ka shitur te blerësi Islam Gjevori. Pala shitëse deklaroi
se në rast se blerësit me kontratën e redaktuar nuk i
kalon toka në pronësi, për çdo detyrim midis blerësit dhe
shitësit do të përgjigjet pala shitëse...*”. Kontrata e
shitjes dhe deklarata noteriale nuk janë regjistruar
në ZRPP-në Korçë.

3. Po ashtu, kërkuesi i ka shitur djalit Marsel
Sulçe pjesën B të furrës nr. 2 me kontratën nr. 2080
kol, nr. 1338 rep., datë 21.8.2002, kurse me
kontratën nr. 1924 kol, nr. 1614 kol, datë
8.6.2005 i ka dhuruar bashkëshortes Tefta Sulçe
sipërfaqen prej 182 m². Të dyja kontratat janë
regjistruar në ZRPP-në Korçë.

4. Subjekti i interesuar Islam Gjevori i është
drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me
kërkesëpadi me objekt “*Detyrimin e palës së paditur të
më njohë pronar mbi objektin furrë nr. 2, si dhe në truallin
prej 793 m²; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të
kontratës nr. 2080 kol, nr. 1338 rep., datë 21.8.2002;
konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së
dhurimit nr. 1924 kol, nr. 1614 rep., datë 8.6.2005 për
pjesën A të furrës nr. 2 solar; fshejjen e regjistrimeve të bëra
në ZRPP-në Korçë për objektin furrë nr. 2 dhe truallin 793
m² në emër të të paditurve dhe regjistrimin e kësaj pasurie
në emër të paditësit*”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë,
me vendimin nr. 1891, datë 11.7.2008, ka vendosur
rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj e në
prova.

5. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 55,
datë 18.2.2009, ka vendosur lënien në fuqi të
vendimit të mësipërm.

6. Gjykata e Lartë, pasi ka shqyrtuar në seancë
gjyqësore rekursin e paraqitur nga subjekti i
interesuar dhe kundërrekursin e kërkuesit, me
vendimin nr. 00-2014-2910 (316), datë 29.5.2014,
ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 55, datë
8.2.2009 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr.
1891, datë 11.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Korçë. Pranimin e padisë së Islam Gjevorit, duke detyruar të
paditurit Sabri Sulçe, Tefta Sulçe dhe Marsel Sulçe të njohin
pronar paditësin mbi objektin furrë nr. 2 me solar dhe
truallin 793 m². Çregjistrimin e pasurisë nga emri i të*



paditurve nga regjistrat e ZRPP-së Korçë. Regjistrimin e kësaj pasurie në emër të paditësit në ZRPP-në Korçë.”.

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 27.5.2016 për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

7.1 Është cenuar *parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka funksionuar si gjykatë fakti duke pranuar rrethana të tjera. Edhe pse Kolegji Civil nuk mund ta zgjidhte çështjen sipas përcaktimeve të nenit 480/d të Kodit të Procedurës Civile, çështjen e pjesëmarrjes në veprimet juridike të bashkëshortes së kërkuesit ai e ka shqyrtuar dhe e ka zgjidhur bazuar mbi opinionet e paditësit dhe jo të provave të marra, pa përdorur asnjë të dhënë apo fakt të rrjedhur nga provat, përveç, sipas tij, mosveprimit të së paditurës Tefta Sulçe.

7.2 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike dhe i ligjshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë duke i dhënë fuqi ligjore prapavepruese vendimit unifikues nr. 1, datë 6.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka ndryshuar vendime gjyqësore të formës së prerë.

7.3 Është cenuar *parimi i barazisë së armëve dhe i arsyetimit të vendimit*, pasi Kolegji Civil nuk ka arsyetuar në lidhje me pretendimet e të paditurve. Arsyetimet e përdorura janë të natyrës teorike, inkohente, diskriminuese dhe jashtë objektit të marrëdhënies juridike në gjykim.

7.4 Është cenuar *parimi i objektivitetit dhe hetimit të pamjaftueshëm*, sepse Kolegji Civil jo vetëm ka mbajtur rol aktiv në përcaktimin e objektit të padisë, por nuk ka mundur të arrijë në konkluzione ligjore për shkak të mungesës së hetimit të plotë të çështjes.

7.5 Është cenuar *parimi i trajtimit të barabartë*, pasi qëndrimi i Kolegjit Civil bie haptazi në kundërshtim me përcaktimet e nenit 83 të Kodit Civil, sipas të cilit veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm.

8. **Subjekti i interesuar Islam Gjevori** ka prapësuar me shkrim si vijon:

8.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar, pasi Kolegji Civil ka respektuar kufijtë e shqyrtimit të

çështjes, duke e përqendruar analizën e tij në mënyrën e fitimit të së drejtës së pronësisë së paditësit mbi pasurinë, cila është fituar në mënyrë të prejdhur dhe jo siç shprehen gjykatat përmes parashkrimit fitues, sipas nenit 168 të KC-së.

8.2 Po ashtu i pabazuar është edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar, sepse Kolegji Civil duke përbushur funksionin e tij rishikues me të drejtë ka korrigjuar gabimin e të dyja gjykatave më të ulëta, të cilat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të lindur nga një marrëdhënie kontraktuale e vitit 1992 ishin bazuar në dispozitat e KC-së të vitit 1994. Po ashtu i pabazuar është edhe argumenti se vendimit unifikues nr. 1/2009 i është dhënë fuqi prapavepruese, për faktin se ky vendim është marrë në datën 6.1.2009, pra përpara se çështja të shqyrtohej në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

8.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve, pasi kërkuesit gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë i është garantuar pjesëmarrja dhe i është dhënë mundësia për të parashtruar nëpërmjet mbrojtësit të tij argumentet ndaj rekursit.

8.4 Pretendim i pabazuar është edhe ai në lidhje me cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit, pasi nga analiza në tërësi e vendimit të Kolegjit Civil rezulton se ai i përbush kërkesat procedurale dhe ato të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese.

8.5 Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit, ato janë thelbësisht të lidhura me zbatimin e ligjit nga ana e Gjykatës së Lartë dhe nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

9. **Subjektet e interesuara Tefta Sulçe dhe Marsel Sulçe** edhe pse janë njoftuar rregullisht, nuk kanë paraqitur komente me shkrim brenda afatit ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e tij janë paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.



11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte, çka nënkupton se kërkuksi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 48, datë 6.7.2015; nr. 25, datë 10.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim kërkuksi nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye ai legjitimohet t'i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate. Gjithashtu, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuksit *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

13. Kërkuksi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor civil të zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk janë respektuar garancitë që burojnë nga e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke cenuar për rrjedhojë parimin e gjykatës së caktuar me ligj, parimin e sigurisë juridike, parimin e barazisë së armëve dhe standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

14. Gjykata, në lidhje me kuorumin e vendimmarrjes, vëren se sipas nenit 133/2 të Kushtetutës dhe nenit 72/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj. Me ndryshimet që iu bënë ligjit organik me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, në nenin 73 është shtuar pika 4 sipas së cilës kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.

15. Gjykata konstaton se çështja konkrete është marrë në shqyrtim nga një trupë prej 7 gjyqtarësh, duke plotësuar kushtin e formimit të shumicës absolute të anëtarëve të saj, sipas nenit 73/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

16. Gjykata, pasi mori në shqyrtim argumentet e paraqitura nga kërkuksi për cenimin e parimeve kushtetuese, çmon se ato nuk ishin të mjaftueshme për t'u konsideruar të bazuara në nivel kushtetues, për rrjedhojë nuk arritën të merrnin shumicën e votave të gjyqtarëve. Në këto kushte Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa konsiderohet e rrëzuar.¹

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f, 134 dhe 133/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 73/4 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 81, datë 30.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"

¹ Votuan për pranimin gjyqtarët: Vladimir Kristo, Gani Dizdari dhe Fatos Lulo. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj dhe Besnik Imeraj.



me sekretare Belma Lleshi, në datën 24.11.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 72 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Ministria e Punëve të Jashtme

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “By Best Duty Free” sh.p.k., Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 497, datë 31.1.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1583, datë 20.6.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-3420, datë 25.11.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 121, 131/f dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases dhe të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, që janë shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, shoqërisë “By Best Duty Free” sh.p.k., që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Subjekti i interesuar, shoqëria “By Best Duty Free” sh.p.k. ka nënshkruar kontratën e qirasë nr. 34, datë 1.7.2005 me subjektin tjetër të interesuar, Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, me anë të së cilës ka marrë me qira disa ambiente të ndodhura në katin përdhe të godinës nr. 8 në rrugën “Skënderbej”, Tiranë.

2. Me anë të shkresës nr. 1243, datë 30.6.2010, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik i ka komunikuar shoqërisë “By Best Duty Free” sh.p.k. përfundimin e kontratës së qirasë. Shoqëria “By Best Duty Free” sh.p.k. ka

pretenduar se zgjidhja e kontratës është një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, pasi Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik nuk mund të kryejë asnjë veprim juridik pa marrë më parë miratimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Për këtë arsye, subjekti i interesuar, shoqëria “By Best Duty Free” sh.p.k., i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së zgjidhjes së kontratës së lartpërmendur dhe pagimin e dëmit të shkaktuar. Subjekti tjetër i interesuar, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në cilësinë e të paditurit në atë gjykim, si dhe kërkuësja, Ministria e Punëve të Jashtme, kanë paraqitur kundërpadi me objekt lirim të sendit dhe shpërblimin e dëmit nga përdorimi i padrejtë i sendit.

3. Gjatë gjykimit në shkallën e parë kërkuësja, në seancën e datës 18.11.2010, ka paraqitur kërkesë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, sepse nuk është ezauruar më parë ankimi administrativ. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj dhe se kundër vendimit mund të bëhet ankim me vendimin përfundimtar. Kërkuësja ka depozituar në datën 23.11.2010 rekurs ndaj vendimit të ndërmjetëm.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 497, datë 31.1.2011, me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtare e vetme, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë; detyrimin e subjekteve të interesuara, Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, t'i shpërblejnë dëmin e shkaktuar shoqërisë “By Best Duty Free” sh.p.k. si rezultat i pavlefshmërisë së zgjidhjes së kontratës së qirasë në masën 30.432.331 lekë; rrëzimin e kundërpadisë si të pabazuar në ligj e në prova, si dhe për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv.

5. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1583, datë 20.6.2012, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 497, datë 31.1.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se pala paditëse nuk ka përcaktuar vlerën e padisë, çka ndikon në formimin jo të drejtë të trupit gjykues (me tre gjyqtarë dhe jo me një sikurse është gjykuar në rastin konkret) dhe se gjykata ka shkelur rëndë ligjin lidhur me



kërkesën e palës së paditur kundërpaditëse në atë gjykim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi nuk ka konsideruar ankimin e paraqitur nga kërkuësja në datën 23.11.2010, por ka vazhduar gjykimin, duke vendosur që ankimi të bëhet bashkë me vendimin përfundimtar.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-460 (91), datë 5.2.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1583, datë 20.6.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin çështjes për rigjykim në atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues. Sipas Gjykatës së Lartë pagimi i taksës për padinë nuk përbën shkak për prishjen e vendimit dhe se palët e paditura në gjykim kanë pasur kohën dhe mundësitë që të kërkojnë shqyrtimin e çështjes nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, por nuk kanë bërë asnjë kërkesë të tillë. Lidhur me çështjen e juridiksionit, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ndaj vendimit të ndërmjetëm të datës 18.11.2010, me anë të të cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rrëzuar kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, nuk rezulton që kjo e fundit të ketë paraqitur ankim të veçantë. Për këtë arsye, sipas Gjykatës së Lartë, me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vazhduar gjykimin e çështjes dhe nuk e ka pezulluar atë.

7. Gjykata e Apelit Tiranë në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 1425, datë 17.6.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 497, datë 31.1.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me disponimet për kërkesëpadinë. Prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e gjykimit për kërkimin e të paditurit kundërpaditës për lirim dhe dorëzimin e sendit. Pranimin e kundërpadisë në lidhje me kërkimin për pagimin e dëmit (qirasë) për periudhën nga 1.7.2010 deri më 30.11.2010 sipas kontratës së qirasë ndërmjet palëve. Edhe në këtë gjykim kërkuësja ka ngritur të njëjtat pretendime mbi mënyrën jo të rregullt të caktimit të vlerës së padisë, si dhe mbi juridiksionin gjyqësor. Gjykata e Apelit i ka konsideruar të kaluara këto pretendime, pasi atyre u është dhënë përgjigje në vendimin e Gjykatës së Lartë që ka kthyer çështjen për rishqyrtim.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-3420, datë 25.11.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur

nga kërkuësja, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

9. **Kërkuësja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykatës) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë dhe ka paraqitur këto shkaqe në mbështetje të pretendimit të saj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor:

9.1 Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj. Kontrata objekt gjykimi është kontratë administrative e lidhur nga organet publike në ushtrim të funksioneve të tyre publike, si e tillë çështja duhej të shqyrtohej nga gjykata administrative.

9.2 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk ka arsyetuar mbi shkaqet e mospranimit të rekursit.

9.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit dhe të drejtën e ankimit në gjykatë, pasi Gjykata e Lartë nuk ka publikuar vendimin e mospranimit. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk është shprehur në lidhje me ankimin e veçantë për çështjen e juridiksionit.

9.4 Është cenuar parimi i barazisë së armëve, pasi shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është bërë shumë shpejt.

10. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik**, në argumentet e paraqitura me shkrim u është bashkuar pretendimeve të kërkuësës dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim me të.

11. **Subjekti i interesuar, shoqëria “By Best Duty Free” sh.p.k.**, ka prapësuar me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

11.1 Mosmarrëveshja e krijuar midis palëve bazohet në një kontratë qiraje dhe jo në një kontratë administrative. Pavarësisht se njëra palë e kontratës është organ i administratës publike, ajo merr pjesë në marrëdhënien juridike në fjalë si subjekt i së drejtës private. Për këtë arsye kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është juridiksioni civil.

11.2 Vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit ka respektuar të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca



kushtetuese lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Është në kompetencën e dhomës së këshillimit të Kolegjit Civil të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs plotësojnë kriteret për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

11.3 Kërkueses nuk i është cenuar e drejta e aksesit për shkak të mospublikimit të vendimit të mospranimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pasi ky i fundit nuk ka detyrim ligjor t'i publikojë këto vendime. Pretendimit për ankimin e veçantë i është dhënë përgjigje nga Gjykata e Lartë.

11.4 Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen me procedurë të përsheptuar bazuar në urdhrin nr. 222, datë 2.10.2013 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit përfshihen në këtë gjykim rastet kur Gjykata e Apelit ka vendosur kthim për rigjykim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

12. Gjykata çmon se kërkuësja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

13. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të

rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Bazuar në këto standarde, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuësës se është cenuar parimi i barazisë së armëve, pasi shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është përsheptuar (4 muaj pas paraqitjes së rekursit) dhe se kjo e fundit nuk ka publikuar vendimin e mospranimit të rekursit, nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Juridiksioni kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete, kur kjo nuk lidhet me shkeljen e standardeve kushtetuese. Për pasojë, Gjykata në vijim do të ndalet në shqyrtimin e atyre pretendimeve që hyjnë në juridiksionin e saj.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të së drejtës së aksesit

15. Kërkuësja pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi në vendimin nr. 00-2014-3420, datë 25.11.2014 nuk ka arsyetuar mbi shkaqet e mospranimit të rekursit. Sipas kërkuësës, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje çështjes së juridiksionit të ngritur prej saj gjatë gjykimit në themel të mosmarrëveshjes, duke cenuar në këtë mënyrë edhe parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

16. Gjykata në jurisprudencën saj ka theksuar se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të



gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për gjykimin në Gjykatën e Lartë, sipas KPC-së (nenet 472 e në vijim), rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet, ndërsa shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Megjithatë, nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit Penal për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 74, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po në këtë drejtim, Gjykata dhe GJEDNJ-ja kanë vlerësuar se arsytimi i kufizuar i vendimit të dhomës së këshillimit shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. GJEDNJ-ja në këtë drejtim ka theksuar, gjithashtu, se arsytimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulën e saj të vendimeve *de plano*, tregon se kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë nga shkaqet ligjore të parashikuara në dispozitat përkatëse ligjore, çka përbën një kërkesë pranueshmërie për ankimin.

GJEDNJ-ja ka vërejtur se aty ku një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje mbi bazën se nuk ka shkaqe ligjore, një arsytim shumë i kufizuar mund të plotësojë kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së (*vendimet e GJEDNJ-së në çështjen Marini v. Shqipërisë, datë 7 korrik 2008, § 106; në çështjen Mishgioni v. Shqipërisë, datë 7 dhjetor 2010, § 51*).

19. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi “gjykatë” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin në shqyrtim, nga materialet e dosjes gjyqësore Gjykata vëren se kërkuesja në seancën e datës 18.11.2010, gjatë gjykimin të çështjes në shkallë të parë, ka pretenduar se çështja nuk i përket juridiksionit civil, sepse nuk është ezauruar më parë ankimi administrativ. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim të ndërmjetëm të së njëjtës datë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, si dhe ka disponuar që kundër këtij vendimi lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar. Kërkuesja, mbështetur në nenin 59 të KPC-së, kundër vendimit të ndërmjetëm të datës 18.11.2010 ka paraqitur rekurs, i cili mban datën e depozitimit 23.11.2010, si dhe vulën e firmën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1583, datë 20.6.2012, lidhur me çështjen e juridiksionit ka arsyetuar se gjykata ka shkelur rëndë ligjin lidhur me kërkesën e palës së paditur kundërpaditëse në atë gjykim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi nuk ka konsideruar ankimin e paraqitur nga kërkuesja në datën 23.11.2010, por ka vazhduar gjykimin, duke vendosur që ankimi të bëhet bashkë me vendimin përfundimtar. Ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2013-460



(91), datë 5.2.2013, ka arsyetuar se nuk rezulton që kërkesja të ketë paraqitur ankim të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm.

21. Gjykata gjithashtu konstaton se gjatë rigjykimit të çështjes në apel, kërkesja ka depozituar kopje të noterizuar të ankimit të veçantë dhe ka ngritur përsëri pretendimin për juridiksionin. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1425, datë 17.6.2013, ka arsyetuar se atij i është dhënë përgjigje në vendimin e Gjykatës së Lartë që ka kthyer çështjen për rishqyrtim. Kundër këtij vendimi kërkesja ka ushtruar rekurs dhe ndër shkaqet e paraqitura është edhe çështja e juridiksionit. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

22. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkeses në lidhje me çështjen e juridiksionit. Kjo e fundit, me vendimin nr. 00-2013-460 (91), datë 5.2.2013, duke e shqyrtuar çështjen në themel dhe duke e rikthyer atë për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e ka konsideruar në kompetencë të saj zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe në këtë mënyrë ka shqyrtuar kryesisht edhe çështjen e juridiksionit. Për këtë arsye, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-3420, datë 25.11.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkesja.

23. Në këto rrethana, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka përmbushur elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit. Edhe pse nëpërmjet një arsyetimi të kufizuar, Gjykata e Lartë, pasi ka vlerësuar shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkesja, ka arritur në përfundimin se ato nuk plotësojnë kërkesat ligjore për kalimin në seancë gjyqësore të çështjes, duke i dhënë përgjigje asaj edhe mbi pretendimin për çështjen e juridiksionit, në respekt të parimit kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj.

24. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkeses për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë të pabazuara dhe nuk duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash²,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 82, datë 30.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 20.9.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 49 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Gjergj Vladi

Subjekte të interesuara: Ministria e Mbrojtjes, Presidenti i Republikës

² Kryetari B. Dedja dhe gjyqtari V. Kristo votuan për pranimin e kërkesës me arsyetimin se është detyrë e Gjykatës së Lartë që në përmbushje të standardit të arsyetimit të vendimit, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe kontrolluese e garantimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, në respekt të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, t'i japë përgjigje pretendimit të kërkeses lidhur me çështjen e juridiksionit.



OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-2211 (258), datë 3.4.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, që kërkonte pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, që kërkonte rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Gjergj Vladi me urdhrin nr. 1157, datë 25.5.1982 të ministrit të Mbrojtjes ka marrë titullin “Oficer aktiv”, duke filluar nga data 16.6.1982. Me dekretin nr. 1738, datë 12.3.1997 të Presidentit të Republikës, kërkuari ka marrë titullin “Gjeneral brigade”.

2. Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 1889, datë 4.9.1997, ka vendosur lirimin nga detyra të kërkuarit, duke e vendosur në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes. Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 2144, datë 22.6.1998, e ka ulur kërkuarin në gradë me motivacionin për shkelje të rënda të disiplinës ushtarake. Kërkuari, me urdhrin nr. 2367/1, datë 24.7.1998 të ministrit të Mbrojtjes, ka dalë në rezervë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3142, datë 1.6.2006, ka vendosur anulimin pjesërisht të dekretit nr. 2144, datë 22.6.1998 të Presidentit të Republikës.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 1436 akti, datë 15.11.2006, ka vendosur lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të vendimit nr. 3142, datë 1.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas ekzekutimit të vendimit, kërkuari është nxjerrë në rezervë me dekretin nr. 5261, datë 13.4.2007 të Presidentit të Republikës.

5. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me padi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, për të paguar shumën që përbëhet nga shpërblimi i pagës, shpërblimi për vjetërsi, shpërblimi për shkallë të gradës, si dhe shpërblimi i pagës së bashkëshortes për periudhën e heqjes së gradës nga data 22.6.1998 deri në datën 11.5.2007.

6. Me vendimin nr. 4483, datë 25.5.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë.

7. Mbi ankimin e kërkuarit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1063, datë 9.6.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 4483, datë 25.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadsisë. Detyrimin e subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, për t’i paguar kërkuarit shpërblimin e pagës për periudhën e heqjes së gradës nga data 22.6.1998 deri në datën 11.5.2007 dhe sigurimet shoqërore. Rrëzimin e kërkesës për pjesët e tjera.

8. Mbi rekursin e subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2211 (258), datë 3.4.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1063, datë 9.6.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 4483, datë 25.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

II

9. *Kërkuari Gjergj Vladi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-2211 (258), datë 3.4.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me argumentet si vijojnë:

9.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka përcaktuar se kërkuari nuk ka qenë ushtarak aktiv dhe nuk ka shërbyer në Forcat e Armatosura. Ky përcaktim është i njëanshëm, i pasaktë dhe joligjor. Kolegji ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi e ka gjykuar çështjen si gjykatë fakti.

9.2 Gjykata e Apelit Tiranë ka marrë vendim mbi të njëjtat prova dhe fakte, duke interpretuar në mënyrë të drejtë vendimin nr. 3142, datë 1.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i



cili ka shpallur të pavlefshëm dekretin e Presidentit “Për ulje grade madhore”.

9.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi janë mbështetur në një akt të shfuqizuar. Ato kanë arritur në një përfundim të gabuar, duke keqinterpretuar ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Urdhri me të cilin kërkuesi është nxjerrë në rezervë mbështetet në një dekret që është shpallur absolutisht i pavlefshëm me vendim gjykatë.

9.4 Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk plotëson kërkesat e një vendimi të arsyetuar. Vendimi nuk është koherent dhe ka përplasje mes argumenteve pasi megjithëse pranohet anulimi i dekretit të Presidentit të Republikës që ka ulur në gradë kërkuesin, nuk është arsyetuar lidhur me pasojat që ka sjellë vendimi për aktet që kanë dalë pas anulimit të dekretit.

10. **Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes**, ka paraqitur prapësime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

10.1 Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 3.4.2014, por meqenëse kjo ditë ka qenë ditë e diel, afati kalon ditën pasardhëse, që është data 4.4.2016. Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është regjistruar në datën 5.4.2016, si rrjedhim kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*.

10.2 Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, pretendimet e kërkuesi kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, si rrjedhim nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

10.3 Kërkuesi pretendon se nuk ka marrë asnjëherë pagën si ushtarak aktiv, pasi realisht nuk ka qenë i tillë, por nga ana tjetër, i referohet vendimit të gjykatës që i ka njohur gradën e hequr, duke pretenduar se konsiderohet ushtarak aktiv dhe duhet të përfitojë pagën përkatëse. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike jo vetëm është i pabazuar, por nuk është ngritur në nivel kushtetues.

10.4 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka gjykuar çështjen në themel dhe nuk ka administruar prova të reja. Për pretendimin e

cenimit të parimit të një gjykate të caktuar me ligj, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë cenimin e kësaj të drejte.

10.5 Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, vendimi i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë i plotëson të gjitha kriteret e arsyetimit.

11. **Subjekti i interesuar, Presidenti i Republikës së Shqipërisë**, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi parashikohet si subjekt nga neni 134/1/i i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis* vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 3.4.2014, që sipas kalendarit është ditë e diel, kurse kërkesa e nisur me postë, mban datën 4.4.2016, për rrjedhojë konsiderohet e depozituar brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

13. Për këtë arsye, Gjykata çmon se pretendimi i subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*, është i pabazuar.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi hyjnë në juridiksionin e kësaj gjykate. Pretendimet janë shqyrtuar në vijim në këndvështrimin e standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

15. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi gjykatat nuk kanë marrë parasysh një vendim gjyqësor të formës së prerë, konkretisht vendimin nr. 3142, datë 1.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur anulimi i dekretit të Presidentit për uljen në gradë të kërkuesit.

16. Gjykata Kushtetuese është shprehur se në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon



dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera (*shih vendimin nr. 12, datë 17.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje (*shih vendimet nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve e zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit me kusht, që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'iu përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata konstaton se në çështjen në shqyrtim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3142, datë 1.6.2006, ka vendosur shfuqizimin e dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë për uljen në gradë të kërkuesit, vendim i cili ka marrë formë të prerë në shkallë të parë, pasi palët nuk e kanë ankimuar. Si rrjedhim, dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë i vitit 1998 për uljen në gradë të kërkuesit është anuluar, duke ngelur në fuqi dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë i vitit 1995, i cili i jepte kërkuesit gradën madhore “Gjeneral brigade”. Pas saj

kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të kërkuar llogaritjen e shpërblimeve për periudhën e heqjes së gradës madhore “Gjeneral brigade”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se “*kërkuesi për periudhën që pretendon dëmshpërblim nuk rezulton të jetë paraqitur në detyrë apo të ketë mbajtur ndonjë funksion në Forcat e Armatosura*”. Në vendim Gjykata e Apelit, në ndryshim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka marrë parasysh vendimin për anulimin e dekretit për heqjen e gradës madhore “Gjeneral brigade”, duke vlerësuar se “*kërkuesi ka rifituar të gjitha të drejtat, duke përfshirë edhe shpërblimin për pagën që ai duhet të kishte marrë me gradën “Gjeneral brigade” për periudhën kohore të kërkuar*”. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e konsideruar arsyetimin e kësaj gjykate si të drejtë.

19. Gjatë shqyrtimit të çështjes gjykata ka konstatuar se në çështje të tjera, ku pretendimet kanë qenë të njëjta me ato të kërkuesit në çështjen konkrete, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme. Konkretisht, me vendimin nr. 00-2014-4371 (596), datë 11.11.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë në të cilin gjykata ka arsyetuar se “*në kushtet kur me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur anulimi i dekretit për uljen në gradë të paditësit V.I., automatikisht mbetet në fuqi dekreti i Presidentit të Republikës që i jep paditësit gradën madhore “Gjeneral brigade”, e si rrjedhim i takojnë të gjitha përfitimet që i jep ligji për periudhën që nuk i ka marrë*”³.

20. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë

³ Çështja me palë paditëse V.I. të paditur Ministrinë e Mbrotjtjes dhe me objekt: “Detyrimin e palës së paditur të paguajë të drejtat ekonomiko-financiare pagat mujore, lejet e zakonshme, normën e veshmbathjes dhe kompensimin në vlerë leku të normës së ushqimit”.



praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në nenin 481 të Kodi i Procedurës Civile (KPrC) dhe në nenin 17 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Kryetari i Gjykatës së Lartë, secili nga kolegjet ose Kolegjet e Bashkuara mund të kërkojnë që gjykata të shprehet në Kolegje të Bashkuara për rekurse të paraqitura nga palët, për të cilat ka praktika të ndryshme të mëparshme në kolegje të thjeshta. Në këto kushte, Gjykata çmon se nisur nga çështja konkrete ka vend për të mbajtur një qëndrim njësoj nga Kolegjet e Bashkuara në lidhje me zbatimin e ligjit për pretendimet e parashtruara para saj.

21. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i bazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuarisi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi është i paqartë.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci

për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në çështjen në shqyrtim vendimi nr. 00-2014-2211 (258), datë 3.4.2014 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përmban palët ndërgjyqëse, vendimin nr. 4483, datë 25.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë, vendimin nr. 1063, datë 9.6.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin është vendosur ndryshimi pjesërisht i vendimit të Gjykatës së Rrethit



Gjyqësor Tiranë, detyrimin e subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes për pagimin e shpërblimit për periudhën e heqjes së gradës, faktin se subjekti i interesuar ka ushtruar rekurs, si dhe shkaqet e rekursit. Kolegji Administrativ ka arsyetuar se kërkuesi për periudhën 22.6.1998 deri më 11.5.2007 nuk ka qenë ushtarak aktiv, si rrjedhim nuk mund të përfitojë pagat e pretenduara. Sipas kolegjit, vendimi nr. 3142, datë 1.6.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka anuluar dekretin për heqjen e gradës madhore por nuk ka vendosur kthimin e kërkuessit si ushtarak aktiv.

28. Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar qëndrimin e mbajtur në vendim lidhur me efektet e vendimit të formës së prerë nr. 3142, datë 1.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është anuluar dekreti që ka ulur në detyrë kërkuessin. Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, kishte detyrimin për të argumentuar pasojat që vijnë si rrjedhim i vendimit të formës së prerë të gjykatës. Kërkuesi nuk ka pretenduar shpërblim page si ushtarak aktiv, por shpërblime që i përfitonin nga grada “Gjeneral brigade”, sipas vendimit të mësipërm, i cili është konsideruar i drejtë dhe i arsyetuar. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se në harmoni me parimin e sigurisë juridike, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të ishte i qartë në arsyetimin e vendimit për pasojat që vijnë nga vendimin nr. 3142, datë 1.6.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi nga mosrespektimi i tij kërkuessit i janë cenuar të drejta të përfituara me vendim të formës së prerë.

29. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuessit Gjergj Vladi për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f dhe nenit 134/1/i të Kushtetutës, të ndryshuar, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-2211 (258), datë 3.4.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 83, datë 30.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 15.12.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 81 Akti që i përket:

KËRKUES: Kadri Resuli, Albano Resuli

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2016-1217 (147), datë 13.7.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/1/i dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i KEDNJ-së dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, Albano dhe Kadri Resuli, që kërkuan pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësit janë dënuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve” në bashkëpunim, mbetur në tentativë.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 133, datë 21.11.2014, ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit Kadri Resuli për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve” në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe në bazë të neneve 283/a, paragrafi 2, e 22 të Kodit Penal (KP), dënimin e tij me 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Albano Resuli për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve” në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe në bazë të neneve 283/a paragrafi 2, e 22 të KP-së, dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim*”.

3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 17, datë 18.2.2015, vendosi lënie në fuqi të vendimit nr. 133, datë 21.11.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-1217 (147), datë 13.7.2016, ka vendosur lënie në fuqi të vendimit nr. 17, datë 18.2.2015 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

II

5. **Kërkuësit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

5.1 Është cenuar e drejta e mbrojtjes. Përgjimi ambiantal i kryer në ambientet e paraburgimit nuk është pasqyruar në mënyrë të plotë. Për këtë material pala mbrojtëse nuk kishte dijeni, sepse nuk i ishte paraqitur prej prokurorit.

5.2 Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Në seksionin D të këtij vendimi titulluar

“Në lidhje me rekursin” jepen në mënyrë të shtjelluar vetëm trajtime teorike dhe jo ballafaqime me çështjen konkrete. Konkluzioni i arritur në këtë vendim është shumë i përgjithshëm.

5.3 Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë dhe e drejta kushtetuese për të mos u vetinkriminuar. Gjestit të tërheqjes së vëmendjes nga xhaxhai për nipin gjykata i ka dhënë një vlerësim të paracaktuar, dhe është marrë krejtësisht i shkëputur nga të gjitha bisedat e bëra ndërmjet të arrestuarve në ambientet e Drejtorisë së Policisë Vlorë.

6. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuësit nuk përmban asnjë element të cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

6.1 Pretendimi i kërkuësve për cenimin e së drejtës së mbrojtjes është i pabazuar, pasi ata kanë qenë të pranishëm në zhvillimin e seancave gjyqësore në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Ky pretendim ka të bëjë me vlerësimin e provave nga gjykata, që është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjithashtu, këtë pretendim kërkuësit nuk e kanë ngritur në ankimin e bërë në Gjykatën e Apelit dhe në rekursin e paraqitur në Gjykatë të Lartë, duke mos shteruar kështu mjetet dhe rrugët e tjera ligjore për t’iu drejtuar kësaj Gjykate.

6.2 Pretendimi i kërkuësve për cenimin e standardit të arsyetimit nga Gjykata e Lartë është i pabazuar. Në rastin në shqyrtim, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i ka përmbushur standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Në vendim janë paraqitur rrethanat e ngjarjes, analiza e veprës penale, si dhe vlerësimi i Kolegjit Penal lidhur me vendimet e gjykatave. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se janë analizuar elementet e veprës penale të kryer nga kërkuësit. Vendimi arsyeton mbi faktin (pasojë/ngjarje, veprime/sjellje, lidhje shkakësore), fajin, kundërligjshmërinë dhe masën e dënimit.

6.3 Edhe pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës kushtetuese për të mos u vetinkriminuar është i pabazuar. Nuk rezulton asnjë e dhënë që të tregojë se gjykatat që kanë shqyrtuar çështjen e



kanë filluar procesin me paragykimin se kërkuesit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen apo që t'i kanë konsideruar të akuzuarit fajtorë përpara dhënies së vendimit përfundimtar. Nuk rezulton që gjykatat të kenë kaluar barrën e provës nga prokurori te të pandehurit. I pabazuar është edhe pretendimi se ata janë deklaruar fajtorë bazuar vetëm në një “gjest” që ka bërë i gjykuari K.R. ndaj të gjykuarit A.R. Gjykatat në dhënien e vendimit nuk janë bazuar në një provë të vetme, por kanë parashtruar të gjitha provat ku kanë bazuar përfundimet e tyre.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

7. Përpara se të shprehet për thelbin e pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) vlerëson të ndalet paraprakisht në vlerësimin e legjitimitetit të kërkuesve për pretendimet e ngritura në kërkesë.

8. Kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30/2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, vërehet se kërkuesit kanë ngritur pretendime të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në vijim janë shqyrtuar sipas radhës së mësipërme pretendimet e kërkuesve.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur

10. Kërkuesit pretendojnë se është cenuar e drejta për t'u mbrojtur. Sipas tyre përgjimi ambiantal i kryer në ambientet e paraburgimit nuk është pasqyruar në mënyrë të plotë. Për këtë material pala mbrojtëse nuk kishte dijeni sepse nuk i ishte paraqitur prej prokurorit. Materiali i përgjimit i paraqitur nga ana e prokurorisë në gjykim ishte i copëtuar dhe jo i plotë.

11. Gjykata ka vlerësuar se veçanërisht në procesin penal barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31

të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Synimi kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (*shih vendimet nr. 49, datë 10.7.2015; nr. 19, datë 18.9.2008; nr. 19, datë 12.6.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre është në juridiksion të gjykitimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj. Parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që këto të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimin nr. 42, datë 12.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata është shprehur se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Shqyrtimi kushtetues i kërkesave individuale udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) dhe një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimin nr. 19, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata ka theksuar se në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës individ mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individ përpara se t'i drejtohet Gjykatës



Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe të rrethanave të çështjes konkrete, duke shqyrtuar materialet e ardhura me kërkesën, Gjykata konstaton se kërkuessit pretendimin e tyre për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur nuk e kanë ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, duke mos shteruar kështu mjetet për t'u drejtuar kësaj Gjykate në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata konstaton se nisur nga parashtrimet e mësipërme të kërkuessve, argumentet mbi të cilat ata mbështesin pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes kanë të bëjnë me çmuarjen nga ana e gjykatës të provave për të krijuar bindjen e brendshme në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e tyre. Si e tillë, kjo çështje i takon sferës së kompetencës së gjykatave të zakonshme, që bëjnë vlerësimin juridik të rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët dhe jo juridiksionit kushtetues, i cili nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor, aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuessve është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor

16. Kërkuessit pretendojnë se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Në seksionin D të këtij vendimi titulluar “Në lidhje me rekursin” jepen në mënyrë të shtjelluar vetëm trajtime teorike dhe jo ballafaqime me çështjen konkrete. Konkluzioni i arritur në këtë vendim është shumë i përgjithshëm.

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i

një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsytuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban Gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka



theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe se masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Referuar vendimit të Kolegjit Penal, Gjykata konstaton se në pjesën hyrëse ai përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të Apelit, si dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit kanë paraqitur rekurs kërkuar. Po ashtu, vendimi i Kolegjit Penal pasqyron në pjesën hyrëse të gjitha shkaqet e parashtruara në rekurs nga kërkuar. Vendimi i Kolegjit Penal përmban në pjesën e tij arsytuese edhe vlerësimin se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit kanë zbatuar drejt ligjin material dhe kanë arsyetuar në mënyrë të hollësishme kryerjen e veprës penale nga kërkuar. Gjithashtu, Kolegji Penal, për pretendimet kryesore të kërkuarve, ka dhënë përgjigje të arsyetuara. Vendimi i Kolegjit Penal nuk rezulton të jetë alogjik dhe nuk përmban ndonjë kundërtënie të hapur ose të fshehtë. Në aspektin substancial vërehet se në vendimin gjyqësor, objekt shqyrtimi, nuk është bërë një arsyetim të detajuar për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të ligjit në lidhje me rrethanat e faktit që u atribuohen kërkuarve. Megjithatë në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese kjo nuk përbën një të metë aq serioze sa ta bëjë të cenueshëm vendimin në fjalë në aspektin kushtetues (*shih vendimin nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuarve është i pabazuar.

D. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë

23. Kërkuar ka pretenduar se është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë dhe e drejta kushtetuese për të mos u vetinkriminuar. Gjestit të tërheqjes së vëmendjes nga xhaxhai për nipin gjykata i ka dhënë një vlerësim të paracaktuar dhe është krejtësisht i shkëputur nga të gjitha bisedat e bëra ndërmjet të arrestuarve në ambientet e Drejtorisë së Policisë Vlorë.

24. Gjykata është shprehur se prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm derisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës

së prerë. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Prezumimi i pafajësisë është trajtuar gjerësisht edhe nga GJEDNJ-ja, e cila ka theksuar se ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individi të akuzuar penalisht, reflekton një opinion ku ai është fajtor përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit (*vendimet në çështjet John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë, 20 qershor 2001*).

26. Mbi bazën e standardeve të mësipërme dhe nga vlerësimi në tërësi i materialeve të paraqitura me kërkesën, nuk rezulton ndonjë e dhënë që të tregojë se gjykatat e zakonshme e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuar i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Gjykatat i kanë bazuar vendimet e tyre në provat e mbledhura gjatë gjykimit, si edhe në dëshmitë e dëshmitarëve. Gjithashtu, argumentet e kërkuarve për këtë pretendim kanë të bëjnë me çmuarjen e provave dhe të kërkesave për marrje provash nga gjykata, të cilat janë çështje që nuk vlerësohen në gjykimin kushtetues. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuarve është i pabazuar.

27. Nisur nga sa më lart, Gjykata, në përfundim të gjykimit, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuar është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.



Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM
Nr. 84, datë 30.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 13.10.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 44 Akti që i përket:

KËRKUES: Shaban Kokaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 10, datë 26.5.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; nr. 168, datë 27.11.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 447, datë 5.3.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/1/i dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, Shaban Kokaj, që kërkoj pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari, me vendimin nr. 67, datë 22.11.1991 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, është dënuar me 18 vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje për

motive të dobëta”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 18.1.1992. Pasi ka vuajtur një pjesë të dënimit, kërkuari është arratisur nga vendi i vuajtjes së dënimit në mars të vitit 1997. Në datën 6.4.2009 kërkuari është arrestuar dhe është futur sërish në burg për vazhdimin e ekzekutimit të dënimit të mbetur.

2. Në datën 19.2.2013, pas lejes shpërblyese, kërkuari nuk është kthyer në vendin e vuajtjes së dënimit. Me vendimin nr. 63, datë 14.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat kërkuari është dënuar me 4 vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”. Ndërsa me vendimin nr. 96, datë 11.11.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka bashkuar dënimin e mbetur (5 vjet e 8 muaj) me dënimin e dhënë si pasojë e largimit të kërkuarit (4 vjet), duke e dënuar përfundimisht me 9 vjet e 8 muaj burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 22.11.2013.

3. Kërkuari nëpërmjet mbrojtësit të tij i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë me kërkesë me objekt: “Mosekzekutimi i vendimit penal të formës së prerë duke u përjashtuar nga vuajtja e dënimit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të vendimit nr. 67, datë 22.11.1991 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. 10, datë 26.5.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 168, datë 27.11.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 10, datë 26.5.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 447, datë 5.3.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari.

II

7. Kërkuari Shaban Kokaj i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në të tria shkallët e gjykimit. Më konkretisht ai ka parashtruar se:

7.1 Arsytimi i vendimit të Gjykatës së Apelit është kontradiktor, pasi nga njëra anë, kjo gjykatë pranon se është parashkruar ekzekutimi i vendimit të formës së prerë dhe, nga ana tjetër, lë në fuqi vendimin e gjykatës së faktit që ka rrëzuar kërkesën e kërkuarit.



7.2 Nga ana e gjykatës së faktit dhe Gjykatës së Apelit nuk është zbatuar drejt ligji material që lidhet e institutin e parashkrimit. Ky veprim i gjykatave vjen në kundërshtim me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, konkretisht me vendimin nr. 7, datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

7.3 Gjykata e Lartë, në kundërshtim me nenin 68/a të Kodit Penal (KP), edhe pse jemi në kushtet e zbatimit të gabuar të ligjit, nuk e ka pranuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi.

8. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar si më poshtë:

8.1 Argumentet e kërkuesit për mospranimin e rekursit nga Gjykata e Lartë duhen vlerësuar në këndvështrimin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Në rastin konkret nuk konstatohet cenim i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë nga mospranimi i rekursit. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit, i ka dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me to.

8.2 Pretendimet e kërkuesit lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit material kanë të bëjnë me vlerësime që u takojnë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* të kërkuesit, neni 131/f i Kushtetutës parashikon se individ mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte.

11. Gjykata është shprehur se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Shqyrtimi kushtetues i kërkesave

individuale udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka theksuar se, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individ mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individ përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe të rrethanave të çështjes konkrete, pas shqyrtimit të materialeve bashkëlidhur kërkesës, Gjykata konstaton se kërkuesi pretendimin e tij për cenimin e standardit të arsytimit nga Gjykata e Apelit nuk e ka ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Në kushtet kur ky pretendim nuk është ngritur dhe nuk është argumentuar në rekursin e paraqitur nga kërkuesi, Gjykata vlerëson se ky i fundit nuk legjitimohet *ratione materiae* për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës për këtë pretendim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë

14. Kërkuesi pretendon se nga ana e gjykatës së faktit dhe Gjykatës së Apelit nuk është zbatuar drejt ligji material që lidhet e institutin e parashkrimit. Ky veprim i gjykatave vjen në kundërshtim me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, konkretisht me vendimin nr. 7, datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës



së Lartë. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë, në kundërshtim me nenin 68/a të KP-së, edhe pse jemi në kushtet e zbatimit të gabuar të ligjit, nuk e ka pranuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi.

15. Bazuar në parimin *jura novit curia*, Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pavarësisht nga mënyra e formulimit të kërkesës, pretendimet e kërkuesit se Gjykata e Lartë edhe pse është ndodhur përpara kushteve të zbatimit të gabuar të ligjit nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit nuk e ka pranuar rekursin, duhet të trajtohen në këndvështrimin e respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë.

16. Gjykata ka pranuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të çdo individi për një proces të rregullt ligjor. Në këtë vështrim, Gjykata mund të vlerësojë mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, që në parim u takon gjykatave të sistemit të zakonshëm, vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste Gjykata analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, gjë që përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e kësaj Gjykate nuk është zgjidhja e një çështjeje konkrete, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka trajtuar të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës si një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo e drejtë e individit përbën garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Në këtë kuptim, e drejta e individit për t'ju drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një

proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'ju drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'ju drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 67, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 21, datë 24.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata, në funksion të kontrollit të respektimit të standardit për akses në gjykim, vlerëson të shprehet paraprakisht për kuptimin kushtetues të cenimit të lirisë së individit dhe të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, si dhe për pasojat që ai sjell ndaj procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë.

21. Sipas nenit 27/1 të Kushtetutës askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Neni 42/1 i Kushtetutës përcakton se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk



mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Në rastin e ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë, ku si pasojë e ekzekutimit të tyre cenohet liria e individit, kjo liri nuk mund të cenohet pa pasur një proces të rregullt ligjor dhe pa qenë e parashikuar në dispozitat ligjore përkatëse.

22. Në legjislacionin penal ligjvënësi, ndër të tjera, ka parashikuar edhe rastet në të cilat vendimet gjyqësore nuk ekzekutohen. Kështu, sipas nenit 68/a të KP-së parashikohet se *“vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar: a) njëzet vjet për vendimin që përmban dënim pesëmbëdhjetë gjer në njëzetepesë vjet burgim”*. Sipas përcaktimit të kësaj dispozite vërehet se ligjvënësi ka parashikuar në të afatet, me kalimin e të cilave, vendimi i dënimit, dhënë ndaj një personi për vepra penale të kryera prej tij, nuk mund të ekzekutohet më. Në këtë rast ndodhemi para parashkrimit të së drejtës së organeve kompetente shtetërore, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve të dënimit. Nga përmbajtja e kësaj dispozite konstatohet se qëllimi i ligjvënësit nëpërmjet kësaj dispozite ka qenë vendosja e një kufizimi kohor për organet kompetente shtetërore të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve të dënimit brenda të cilit këto organe kanë të drejtë të vënë në ekzekutim një vendim penal të formës së prerë. Duke pasur parasysh afatet e vendosura në nenin 68 të KP-së, kjo e drejtë e këtyre organeve shuhet me kalimin e këtyre afateve kohore.

23. Gjithashtu, neni 480 i KPP-së parashikon se në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë kompetente të vendosin për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, si dhe për çdo rast tjetër të parashikuar me ligj. Po sipas kësaj dispozite kur vërtetohet shuarja e veprës penale ose e dënimit, gjykata e deklaron këtë edhe kryesisht, duke marrë masat përkatëse. Kështu, në kuptim të neneve 42 dhe 135 të Kushtetutës gjykata është organi kompetent që gjykon akuzat e ngritura ndaj individëve për vepra penale, dhe me konstatimin e rasteve të parashikuara në dispozitat penale të sipërcituara autorizohet të deklarojë shuarjen e dënimit edhe kryesisht.

24. Gjykata konstaton se në datën e largimit të kërkuarit nga vendi i vuajtjes së dënimit (19.2.2013) afati i ekzekutimit të dënimit të tij ishte parashkruar, pasi kishin kaluar 20 vjet nga momenti kur vendimi nr. 67, datë 22.11.1991 kishte marrë formë të prerë. Në këto kushte, kur nga momenti që vendimi ka marrë formë të prerë kanë kaluar 20 vjet, ekzekutimi i dënimit konsiderohet i parashkruar.

25. Gjykata vëren se moszbatimi i dispozitave penale në kontekstin e fakteve të pranuar, ka cenuar kërkuarin në të drejtat e tij kushtetuese të parashikuara nga nenet 27 dhe 42 të Kushtetutës, si pasojë e një gjykimi jo të drejtë, duke i kufizuar atij lirinë dhe duke cenuar kështu edhe sigurinë juridike. Gjykata rithekson se parimi i shtetit të së drejtës, ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Disa nga elementet e shtetit të së drejtës janë: parimi i ndarjes së pushteteve, siguria juridike dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (*shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme, të tilla si pavarësia e shtetit dhe tërësia e tij territoriale, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendi kushtetues, prona etj. (*neni 1/b të KP-së*). Ai bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit (*neni 1/c të KP-së*). Ky legjislacion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit, nga ana tjetër (*shih vendimet nr. 1, datë 12.1.2011; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykatat e faktit, megjithëse e kanë konstatuar parashkrimin në vendimet e tyre, kanë arsyetuar stricto sensu se ato janë përpara një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili nuk e ka konstatuar parashkrimin dhe për këtë arsye ato nuk mund të disponojnë mbi çështjen, pasi do të cenonin parimin e gjësë së gjykuar. Sipas tyre, duke qenë se ka një vendim penal të formës së prerë, me të cilin është bërë bashkimi i dënimeve afati i parashkrimit do të fillojë nga



data kur vendimi i bashkimit të dënimeve ka marrë formë të prerë. Në vlerësim të Gjykatës ky arsyetim i gjykatave të faktit e ka vendosur kërkuesin në situatën ku atij i duhet të vuajë një dënim i cili është parashkruar. Këto shkelje të bëra nga gjykatat e faktit nuk janë konstatuar as nga Gjykata e Lartë. Vetë Gjykata e Lartë në vendimin unifikues të saj nr. 7/2002, i cili ka interpretuar parashkrimin e dënimit penal (nenin 68 të KP-së), është shprehur se [...]nuk mund të ketë zgjatje të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit për asnjë lloj shkaku. Kjo vlen si për rastet kur vendimi i dënimit nuk është vënë fare në ekzekutim, ashtu edhe për rastet kur ky vendim është vënë në ekzekutim dhe pasi i dënuari ka filluar të vuajë dënimin, vuajtja e mëtejshme e tij ndërpritet për çfarëdolloj shkaku, sikurse mund të jetë edhe largimi i të dënuarit nga vuajtja e dënimit[...]. Kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për mosekzekutimin e vendimit penal për shkak të parashkrimit, por është larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit. Parashkrimi i dënimit nuk është konstatuar as nga gjykata e shkallës së parë kur ka bashkuar dënimet, por vetëm pasi gjykata e shkallës së parë ka dhënë një vendim të ri ku ka bashkuar dënimet, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për mosekzekutim të dënimit për arsye të parashkrimit të tij.

27. Gjykata vëren se edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkuesi ka evidentuar faktin se ekzekutimi i vendimit të dënimit nr. 67, datë 22.11.1991 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është parashkruar, për arsye se kanë kaluar 20 vjet nga momenti i marrjes formë të prerë të vendimit. Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 35, datë 20.12.2005; nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi

i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kërkuesi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese për sa i përket parashkrimit të ekzekutimit të vendimit, ku si pasojë e moskonstatimit të këtij fakti atij i është cenuar liria e tij. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit, duke mos u shprehur dhe mos u dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese. Gjykata për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 18, datë 14.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej mbi to në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit.

28. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se në çështjen konkrete Gjykata e Lartë ka lejuar një proces të parregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës, duke mos ushtruar funksionin e saj kontrollues për respektimin e standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 447, datë 5.3.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.



- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 85, datë 30.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 25.10.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 52 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Shoqëria “47ek79 & Iliriada PKS” sh.p.k.

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria “Anxhela P.C. Konstruksion” sh.p.k.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2016-288, datë 16.1.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuases, që është shprehur për pranimin e

kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga dosja gjyqësore rezulton se në datën 12.11.2007 midis kërkuarit dhe subjektit të interesuar është lidhur një kontratë bashkëpunimi me nr. 4848 rep., 1186 kol. Në bazë të kësaj kontrate, palët kanë rënë dakord për të marrë pjesë bashkërisht në një tender të organizuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, që kishte për objekt: “Studimi, projektimi, fizibiliteti dhe projektzbatimi i *by pass*-it Plepa–Kavajë–Rrogzhinë”. Pra, qëllimi i palëve ishte marrja pjesë në tenderin e sipërcituar dhe më pas realizimi i projektit, në rast se tenderi do të fitohej.

2. Me qëllim që të krijoheshin lehtësira për pjesëmarrjen në tender, si dhe për të plotësuar kërkesën e investitorit që të kishte vetëm një përfaqësues në procesin e tenderimit, subjekti i interesuar lëshoi një prokurë të posaçme për kërkuarin me të njëjtën datë me atë të kontratës së bashkëpunimit. Në këtë prokurë, në kushtet e mirëbesimit, subjekti i interesuar i dha kompetenca të plota kërkuarit në rast se do të fitohej tenderi i mësipërm. Një nga këto kompetenca ishte dhe e drejta për të tërhequr shumat e likuiditeteve në zbatim të kontratës me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve. Përveç faktit të mirëbesimit, subjekti i interesuar ishte i detyruar që ta jepte këtë prokurë, sepse ishte kërkesë e autoritetit kontraktor që në rast bashkëpunimi shoqërisht, kontakti të ishte me një përfaqësues.

3. Më konkretisht, disa nga parashikimet e kësaj kontrate ishin: “*Shoqëritë do të punojnë sipas raporteve të caktuara prej fillimit deri në përfundim të objektit, të pasqyruara në situacionet e paraqitura prej tyre, punimet, shërbimet nga të tretët si dhe të gjitha detyrimet e tjera ndaj shtetit. Para investitorit mbajnë përgjegjësi teknike dhe ligjore të dyja shoqëritë. Të ardhurat që do të realizohen nga projektimi i objekteve do të administrohen në transparencë të plotë nga të dyja shoqëritë. Nga të ardhurat e realizuara do të zbriten të gjitha shpenzimet e bëra dhe detyrimet ndaj shtetit. Fitimi neto që do të realizohet do të ndahet midis shoqërive në raportet e caktuara 83 % shoqëria “Iliriada PKS” sh.p.k. dhe 17% shoqëria “Anxhela P.C. Konstruksion” sh.p.k.*”.



4. Rezulton se në bazë të kontratës së bashkëpunimit të dyja palët (paditësi dhe i padituri në proces) u shpallën fituese të tenderit të organizuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve dhe pranë kësaj drejtorie është paraqitur projekti, në faza të ndryshme, sipas zërave dhe procesverbaleve të dorëzimit. Duke qenë se projekti është realizuar me sukses dhe nuk pati asnjë vërejtje nga autoriteti kontraktues, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve është disbursuar një pjesë e fondeve në favor të shoqërisë “Iliriada P.K.S.” sh.p.k. (sipas faturave tatimore të administruara në proces). Subjekti i interesuar, “Anxhela P.C. Konstruksion” sh.p.k. i është drejtuar gjykatës me padi me objekt: “Zbatimi i kontratës së bashkëpunimit të lidhur midis palëve në datën 12.11.2007, duke e detyruar të paditurin t’i paguajë paditësit shumën 7.604.100 lekë, interesat bankarë mbi këtë shumë, si dhe 17% të shumës së patërhequr prej paditësit në momentin që do t’i tërheqë nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.”.

5. Subjekti i interesuar, në padinë e ngritur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka pretenduar se ai, si palë në kontratën e bashkëpunimit, ka kryer të gjitha detyrat e tij dhe nuk ka marrë pjesën e tij të të ardhurave. Pagesa sipas kontratës do të ishte 17% e të gjithë vlerës së kontratës, rrjedhimisht pala e paditur duhej t’i jepte palës paditëse 17% të shumës së çdo kësti të tërhequr. Njëkohësisht, pala paditëse ka pretenduar edhe kamatat ligjore të çdo shume që ajo duhej të merrte nga pala e paditur nga momenti që kjo e fundit tërhiqte paratë nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2063, datë 5.3.2012, ka vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur, “47 EK 79 & Iliriada PKS” sh.p.k., t’i paguajë paditësit “Anxhela PC Konstruksion” sh.p.k. shumën 7.604.100 lekë në zbatim të kontratës së bashkëpunimit nr. 4848 rep. dhe nr. 1186 kol. datë 12.11.2007, 1.162.260 lekë kamatëvonesë mbi shumën 7.604.100 lekë të llogaritura deri në datën 23.1.2012, si dhe 1.424,53 lekë interesa në ditë mbi shumën 7.604.100 lekë, duke filluar nga data 23.1.2012 deri në momentin e ekzekutimit të vendimit. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.”.*

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2198, datë 25.9.2012, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 2063, datë 5.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rrëzimin e kërkesëpadisë. Ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore palës paditëse.”.*

8. Kundër këtij vendimi subjekti i interesuar ka bërë rekurs në datën 22.10.2012, nëpërmjet të cilit ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkaqet e parashtruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-288, datë 16.1.2016, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 2198, datë 25.9.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2063, datë 5.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”.*

II

10. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

10.1 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi ai ka dalë tej kompetencave të tij, duke prishur vendimin e një gjykate më të ulët dhe lënë në fuqi ë vendimin e një gjykate tjetër. Kolegji nuk u është referuar provave të marra gjatë gjykimit në gjykatat më të ulëta, duke tejkaluar tagrat e tij në gjykimin si gjykatë ligji. Njëkohësisht, ai ka cenuar edhe parimin e barazisë së armëve, pasi e ka vënë kërkuesen në një pozitë të pafavorshme, duke marrë në shqyrtim faktet e çështjes, jo zbatimin e ligjit.

10.2 Vendimi i Kolegjit Civil ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi ka kaluar për gjykim një çështje që nuk plotësonte kriteret për t’u shqyrtuar në seancë, duke qenë se nuk paraqiste shkaqe të ligjit, por të fakteve.

10.3 Është cenuar parimi i barazisë së armëve, pasi Kolegji Civil nuk ka marrë parasysh pretendimet dhe argumentet e kërkueses.

11. **Subjekti i interesuar** kundërshton pretendimet e kërkueses, duke parashtruar se:

11.1 Pretendimet e kërkueses nuk janë ngritur në nivelin kushtetues, ato janë çështje që lidhen me juridiksionin e zakonshëm gjyqësor dhe nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

11.2 Pretendimi se Kolegji Civil ka dalë jashtë funksionit të tij, duke shqyrtuar prova e fakte që nuk janë marrë në gjykimet e mëparshme, nuk qëndron, pasi Kolegji Civil nuk ka shqyrtuar asnjë provë të re. Thelbi i gjykimit ka qenë mënyra e zbatimit të marrëveshjes midis dy shoqërive gjatë procesit të prokurimit publik. Pikërisht te ky fakt është ndalur edhe Kolegji



Civil, i cili ka theksuar se në këtë rast duhet të gjejnë zbatim rregullat e ligjit për prokurimin publik, pra ka orientuar gjykatën drejt zbatimit të duhur të ligjit.

11.3 Nuk qëndron as pretendimi se është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi është në kompetencën e Kolegjit Civil të vendosë se kur plotësohen kriteret që një rekurs të shqyrtohet në seancë ose në dhomë këshillimi.

11.4 Nuk qëndron as pretendimi se është cenuar barazia e armëve, pasi palët gjatë gjykimit para Kolegjit Civil kanë pasur mundësi të paraqesin pretendimet dhe argumentet e tyre.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuar

12. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuar lidhet drejtpërdrejt me iniciimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkuar duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 52, datë 20.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata vëren se kërkuarja legjitimohet *ratione personae*, si një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1/g të Kushtetutës. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, Gjykata çmon se ajo legjitimohet për pretendimin e mosnjohimit të zhvillimit të seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë. Kërkuarja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar që ka parashikuar neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

B. Për pretendimin se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj

14. Lidhur me këtë pretendim Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një

“gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë, përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj, nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe të zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjëshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimet nr. 1, datë 29.1.2016; nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata, në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të



njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë. Neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 11, datë 3.3.2016; nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Referuar vendimit të Kolegjit Civil rezulton se ai ka parashtruar fillimisht rolin e funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, duke konsideruar se *“...procesi gjyqësor civil ka për qëllim zhvillimin e një gjykimi që konsiston në vlerësimin nga pikëpamja e së drejtës të një fakti ose një grup faktesh që domosdoshmërisht para se të vlerësohen nga gjykata duhet të vërtetohen (në formën e parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile) dhe që përfundon me dhënien e një vendimi i cili duhet t’u përgjigjet dispozitave ligjore të zbatueshme për rastin konkret. Po ashtu, referuar dispozitave procedurale civile, parashtrimi i kërtimeve dhe pretendimeve është në disponibilitetin e palës iniciuese të procesit (paditësit), por njëkohësisht është detyrë e gjykatës që të zbulojë shkaktuesin e padisë së paditësit, duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar te dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj (vendimi unifikues nr. 3/2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)”*.

18. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, gjithashtu, ka vlerësuar se pavarësisht dispozitave ligjore të cilat janë referuar nga pala paditëse në kërkesëpadi, për rregullimin e mosmarrëveshjeve të kësaj natyre, pra përveç dispozitave të Kodit Civil (nenet 476-495), duhet të mbahej në konsideratë edhe rregullimi i fushës së prokurimit publik, konkretisht ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe veçanërisht dispozitat e VKM-së nr. 1, datë 10.1.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, që bëjnë fjalë për pjesëmarrjen në tender të një bashkimi operatorësh. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se, duke analizuar pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe në tërësi gjykimin e çështjes,

në kundërshtim me kërkesat e nenit 126 të KPC-së, kjo gjykatë ka arritur në një konkluzion të gabuar, që nuk përkon me analizën e rrethanave të çështjes dhe nuk e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi (neni 16 i KPC) të zbatueshme në rastin konkret. Gjykata e Apelit, në kundërshtim me nenin 29 të KPC-së, nuk ka çmuar në tërësi rrethanat e çështjes, duke mos analizuar në mënyrë të saktë parashikimet e kontratës së bashkëpunimit të datës 12.11.2007 (lidhur me vullnet të lirë mes palëve), situacionet e paraqitura para autoritetit kontraktues (në emër të dy shoqërive) dhe faktin se pagesat janë kryer po ashtu në emër të bashkimit të dy shoqërive fituese të tenderit.

19. Bazuar në këtë arsyetim, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka çmuar të drejtë arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që, sipas tij, përkon me analizën e rrethanave të çështjes dhe mënyrën e zgjidhjes së saj, e cila, në përputhje me kërkesat e normave procedurale, ka kryer një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin në çështjen objekt gjykimi (neni 14 i KPC-së). Kolegji Civil, pasi ka marrë në shqyrtim vendimet e gjykatave më të ulëta, ka konkluduar se gjykata e rrethit gjyqësor u ka dhënë përgjigje një sërë pretendimeve të palëve, ka bërë një analizë tërësore dhe objektive të provave, ashtu siç e parashikojnë rregullat e KPC-së, dhe në përfundim ka vendosur zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj.

20. Gjykata mori në shqyrtim pretendimin e kërkuës se Kolegji Civil ka shqyrtuar prova dhe fakte që nuk kanë qenë pjesë e debatit gjyqësor në shkallët më të ulëta, duke dalë jashtë juridiksionit rishikues, vlerëson se ai nuk është i bazuar. Referimi ose përmendja e licencës në arsyetimin e vendimit të Kolegjit Civil nuk duhet parë në këndvështrimin e trajtimit të saj si provë më vete dhe e shpërndarë ku bazohet vendimi i atij Kolegji. Ky element duhet parë në kontekst të të gjithë arsyetimit të vendimit dhe si konkluzion logjik i analizës së të gjithë procesit të bashkëpunimit midis dy shoqërive për realizimin e kontratës së lidhur mes tyre, me qëllim kryerjen e një shërbimi në përputhje me kërkesat e prokurimit publik.



21. Në këto kushte, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Civil si gjykatë rishikuese është kompetent të vlerësojë se interpretimi i ligjit i bërë nga Gjykata e Rrethit Tiranë ka qenë i drejtë apo jo. Pas këtij vlerësimi ai ka arritur në përfundimin se interpretimi i bërë nga Gjykata e Rrethit Tiranë ka qenë i ndryshëm nga ai i bërë prej Gjykatës së Apelit Tiranë. Mbështetur në këtë konkluzion, Kolegji Civil, pasi ka analizuar faktet dhe rrethanat sipas provave të administruara nga gjykatat, ka arritur në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë duhet të lihet në fuqi.

C. Për pretendimin se është cenuar parimi i sigurisë juridike

22. Kërkuesja ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Civil ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi ai Kolegji ka kaluar për gjykim një çështje që nuk plotësonte kriteret formale për t'u shqyrtuar në seancë, duke qenë se nuk paraqiste shkaqe të ligjit, por të fakteve. Në këtë mënyrë, Kolegji Civil, sipas kërkueses, ka vepruar në kundërshtim me praktikën e tij, duke cenuar sigurinë juridike të palëve në proces.

23. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

24. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (shih vendimin nr. 19, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

25. Gjykata ka theksuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata u kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (shih vendimet nr. 4, datë 5.2.201 të Gjykatës Kushtetuese).

26. Referuar këtyre standardeve, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil, brenda juridiksionit të tij si gjykatë rishikuese, i ka dhënë zgjidhje përfundimtare konfliktit, gjë e cila është tërësisht në kompetencën e tij.

27. Për sa i takon pretendimit për mosrespektimin e të barazisë së armëve, Gjykata konstaton se kërkuesja nuk arriti të paraqesë argumente të nivelit kushtetues në funksion të pretendimit të saj.

28. Nisur nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkueses janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,



VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar),
Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Fatmir
Hoxha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Gani Dizdari,
Besnik Imeraj

MENDIM PAKICE

Nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës për këto arsye:

A. Për pretendimin se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj

1. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi ai ka dalë tej kompetencave të tij, duke prishur vendimin e një gjykate më të ulët dhe lënë në fuqi ë vendimin e një gjykate tjetër. Kolegji nuk u është referuar provave të marra gjatë gjykimit në gjykatat më të ulëta, duke tejkaluar tagrat e tij në gjykimin si gjykatë ligji. Njëkohësisht, ai ka cenuar edhe parimin e barazisë së armëve, pasi e ka vënë kërkuuesen në një pozitë të pafavorshme, duke marrë në shqyrtim faktet e çështjes, jo zbatimin e ligjit.

2. Lidhur me këtë pretendim Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë, përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj, nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe të zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimet nr. 1, datë 29.1.2016; nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Referuar vendimit të Kolegjit Civil rezulton se ai ka marrë në shqyrtim mënyrën e vlerësimit të provave dhe fakteve nga gjykatat më të ulta duke konsideruar se “*Gjykata e Apelit, në kundërshtim me nenin 29 të Kodit të Procedurës Civile, nuk ka çmuar në tërësi rrethanat e çështjes, duke analizuar në mënyrë të saktë mbi parashikimet e kontratës së bashkëpunimit datë 12.11.2007 (lidhur me vullnet të lirë mes palëve), situacionet e paraqitura para autoritetit kontraktues (në emër të dy shoqërive) dhe faktin se pagesat janë kryer po ashtu në emër të bashkimit të dy shoqërive fituese të tenderit. Veçanërisht, Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore të VKM nr. 1, datë 10.1.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, ku në Kreun VII “Kushte të përgjithshme për zbatim”, Pika 2 “Bashkimi i operatorëve ekonomike” parashikohet mënyra e rregullimit të paraqitjes në një procedurë prokurimi të një*



bashkimi operatorësh (sikurse ka qenë rasti në shqyrtim). Në këtë pikë parashikohen qartësisht detyrime për bashkimin e shoqërive kundrejt autoritetit kontraktues për të njoftuar prishjen e bashkimit dhe/apo mosplotësimin e kushteve nga njëra shoqëri, të cilat çojnë deri në prishjen e kontratës me entin prokurues (sipas germave “ç” dhe “d”) dhe që janë të lidhura pikërisht me qëllimin pse kryhet një bashkim shoqërisht: që palët të plotësojnë dhe zotërojnë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën (që normalisht asnjëra palë nuk ka arritur t’i përmbushë e vetme). Sikurse rezulton nga aktet e dosjes dhe është pranuar nga gjykatat, pala e paditur, përveç se në pretendimet e ngritura në këtë gjykim, në asnjë moment gjatë zbatimit të kontratës së projektimit, nuk ka paraqitur ndonjë pakënaqësi apo njoftuar mospërmbushje të pjesës së shërbimit të marrë përsipër nga pala paditëse si kundrejt vetë kësaj të fundit apo, në zbatim të dispozitave sa më sipër, kundrejt autoritetit kontraktues. Në këto kushte, nuk mund të arrihet në konkluzionin se pala paditëse nuk ka përmbushur detyrimet e saj në realizimin e projektit, i cili bazuar dhe në situacionet e paraqitura dhe projektin e miratuar nga enti prokurues është paraqitur dhe miratuar si shërbim/punë e kryer nga të dy shoqëritë. Aq më tepër kur pala paditur nuk plotësonte dot një nga kushtet e realizimit të projektit, “Projektet e Veprave të artit deri në 10 m”, pasi nuk zotëronte licencën përkatëse (që ka qenë qëllimi pse është lidhur kontrata e bashkëpunimit mes palëve).”.

5. Bazuar në këtë arsyetim, ne gjyqtarët në pakicë jemi të qëndrimit se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka tejkalluar kompetencën e tij rishikuese duke marrë përsipër vlerësimin që duhej të ishte bërë nga gjykatat e faktit. Pasja ose jo e licencës nga palët në gjykim apo fakti i përmbushjes ose jo të shërbimeve të marra përsipër prej tyre, nuk është në natyrën e gjykatës së ligjit, siç është Gjykata e Lartë. Analiza e plotë e rrethanave të çështjes dhe mënyrën e zgjidhjes së saj, bazuar në kërkesat e normave procedurale, kryerja e hetimit gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin në çështjen objekt gjykimi është në kompetencën e gjykatave të faktit dhe jo e Gjykatës së Lartë.

6. Për sa më lart, ne jemi të qëndrimit se pretendimi i kërkuës se Kolegji Civil ka shqyrtuar prova dhe fakte që nuk kanë qenë pjesë e debatit gjyqësor në shkallët më të ulëta, duke dalë jashtë juridiksionit rishikues, është i bazuar dhe duhej të ishte pranuar nga Gjykata.

Referimi ose përmendja e licencës në arsyetimin e vendimit të Kolegjit Civil duhej të ishte trajtuar si një provë më vete, ku bazohet kryesisht arsyetimi i vendimit të atij Kolegji. Pavarësisht se arsyetimi duhet të shihet në të gjithë kontekstin e tij, Kolegji Civil ka analizuar me detaje të gjithë procesin e bashkëpunimit midis dy shoqërive (palëve) për realizimin e kontratës së lidhur mes tyre, me qëllim kryerjen e një shërbimi në përputhje me kërkesat e prokurimit publik, duke marrë kështu rolin e gjykatës së faktit, në kundërshtim me rolin rishikues të ligjit që ka ai Kolegji.

7. Për këto arsye, Gjykata duhej të kishte pranuar kërkesën, duke vendosur shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, sipas standardeve kushtetuese të përcaktuara nga kjo Gjykatë.

Anëtarë: Besnik Imeraj, Vitore Tusha, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 86, datë 30.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 11.10.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 56 Akti që i përket:

KËRKUES: Unioni i Shoqërive Hidrokarbure Shqiptare

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.



Pezullimi i zbatimit të pikës 9 të kreut II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” deri në përfundim të gjykimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 18, 131/c dhe 134/1/h të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 28, 29, 30, 45 dhe 49/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, Unionit të Shoqërive Hidrokarbure Shqiptare (USHSH), që kërkoj pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të neneve 19, 20 e 21 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, ka miratuar vendimin nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (në vijim VKM nr. 970/2015).

2. Ndër të tjera, pika 9 e kreut II të këtij vendimi përcakton: “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrave lubrifikante është 5.000.000 (pesë milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 2.000.000 (dy milionë) lekë për bashkitë e tjera”.

3. Përpara miratimit të VKM-së nr. 970/2015, tarifa për licencat për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, dhe vajrave lubrifikante ka qenë 100.000 (njëqind mijë) lekë, e përcaktuar kjo në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”.

Faqe | 27642

II

4. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 10.6.2016 me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

4.1 *Për legjitimitimin*. Në lidhje me legjitimitimin *rationae personae*, unioni është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 5329, datë 4.5.2016. Anëtarë të tij janë shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve në Shqipëri. Unioni legjitimohet *ratione temporis*, sepse vendimi në fjalë i KM-së është brenda afatit 3-vjeçar ligjor për t'u kundërshtuar para Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Unioni legjitimohet *ratione materiae* sepse mbron interesat e shoqërive të tregtimit të hidrokarbureve dhe VKM-ja nr. 970/2015 është drejtpërdrejtë e zbatueshme kundrejt të gjithë anëtarëve të unionit. Gjithashtu, për sa i përket juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, unioni pretendon se për shkak se akti nënligjor i drejtohet të gjithë kategorisë së subjekteve tregtare që veprojnë në fushën e hidrokarbureve, jo në mënyrë nominative, por në mënyrë të cilësuar për shkak të karakteristikave të kësaj kategorie, ai është një akt me karakter normativ, i cili hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate.

4.2 *Për themelin e çështjes*:

4.2.1 Përcaktimi i bërë në pikën 9 të kreut II të VKM-së, duke rritur nivelin e tarifës ligjore për licencim, cenon parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike me vendosjen e një tarife joproporcionale dhe në shkelje të rezervës ligjore duke kufizuar një të drejtë dhe liri themelore me akt nënligjor dhe jo me ligj, sipas përcaktimit të nenit 17 të Kushtetutës. Kjo tarifë aplikohet në mënyrë drastike dhe aspak graduale, pa parashikuar një periudhë tranzitore dhe për më tepër kur nuk parashikohet në rregullimin e ri asnjë diferencë tarifore midis aplikimit fillestar për licencë dhe rinovimit të saj.

4.2.2 Tarifat e reja të vendosura me VKM-në nr. 970/2015 cenojnë parimin e sigurisë juridike, duke rënduar ndjeshëm situatën e kërkesit, por edhe të gjithë anëtarëve të unionit për shkak të shumëfishimit me dhjetëra herë të tarifës së



licencës. Të gjithë anëtarët e unionit, bazuar në situatën e mëparshme të rregullimit të sistemit të licencimit, kanë bërë planbizneset e tyre, përfshirë marrjen e kredive bankare, investimet, parashikimin e investimeve të reja etj. Bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, një barrë tatimore e tepruar dhe joproporcionale cenon sigurinë juridike dhe konceptin e “*parashikueshmërisë*”.

4.2.3 Tarifat e licencimit për këtë sektor janë diskriminuese, sepse ato për sektorët e tjerë janë shumëfish më të ulëta.

4.2.4 Në kushtet kur rregullimet e pikës 9 të kreut II të VKM-së nr. 970/2016 prekin interesat e shoqërive të hidrokarbureve, ekzistojnë shkaqe të përligjura për të vendosur pezullimin e ekzekutimit të këtij akti, pasi ai potencialisht sjell pasoja të dëmshme për anëtarët e USHHSH-së, të cilat, nëse vijnë, nuk do të mund të shmangen në rastin e një vendimi përfundimtar në favor të kërkuarit.

5. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, ka parashtruar prapësimet si vijon:

5.1 VKM-ja nr. 970/2015 nuk cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike, pasi fusha e hidrokarbureve nuk përbën në asnjë rast element që mund të konsiderohet si premisë për t'u përfshirë në kushte dhe kritere si ato që do ta cenonin këtë liri. Synimi i miratimit të kësaj VKM-je ka qenë përmirësimi i veprimtarisë së të gjitha subjekteve nëpërmjet krijimit të kushteve të barabarta, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së interesit publik, nga ana tjetër. Detyrimet e subjekteve në referim të kësaj VKM-je nuk interferojnë në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

5.2 VKM-ja nuk ka shkelur rezervën ligjore. Ligji nr. 8450, datë 24.2.2000 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar ka autorizuar Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore, ka përcaktuar organin kompetent, si dhe çështjet specifike që duhen rregulluar.

5.3. Nuk kemi cenim të parimit të proporcionalitetit. Është e provuar se të gjitha subjektet e përfaqësuara nga kërkuari kanë paguar tarifën, e cila është vendosur me VKM-në nr. 970/2015 dhe kanë vijuar normalisht aktivitetin e tyre. Tarifat, përfshirë edhe atë të kontestuar nga kërkuari, janë pjesë e sistemit financiar të shtetit. Këshilli i Ministrave ka marrë

në mënyrë vijuese një sërë nismash rregulluese në sektorin e hidrokarbureve. Të shumta kanë qenë edhe fushatat për të garantuar cilësinë e karburanteve dhe ruajtjen e mjedisit nga pasojat e përdorimit të tyre. Pas gjithë problematikave të hasura në praktikë, u kërkuar dhe u gjetën mjetet e përshtatshme të parashikuara në VKM-në nr. 970/2015.

5.4. Në lidhje me pezullimin e zbatimit të VKM-së nr. 970/2015, nuk ndodhemi në kushtet e nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Nuk ndodhemi përpara cenimit të një interesi shtetëror, shoqëror, individual konkret dhe jo të hamendësuar si kusht i vetëm për të vendosur pezullimin e zbatimit të aktit. VKM-ja nr. 970/2015 ka mbi 8 muaj që zbatohet, për rrjedhojë ka më shumë se 8 muaj që subjektet e përfaqësuara nga kërkuari i nënshtrohen rregullimit të saj. Gjatë kohës së zbatimit të VKM-së nuk është evidentuar në praktikë asnjë problematikë në lidhje me zbatueshmërinë e pikës 9 të kreut II të saj.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën e pezullimit të zbatimit të VKM-së objekt shqyrtimi

6. Kërkuari ka kërkuar pezullimin e zbatimit të VKM-së nr. 970/2015, duke argumentuar se në kushtet kur rregullimet e pikës 9 të kreut II të kësaj VKM-je prekin interesat e shoqërive të hidrokarbureve, ekzistojnë shkaqe të përligjura për të vendosur pezullimin e ekzekutimit të këtij akti, për arsye se potencialisht sjell pasoja të dëmshme për anëtarët e USHHSH-së, të cilat, nëse vijnë, nuk do të mund të shmangen në rastin e një vendimi përfundimtar në favor të kërkuarit.

7. Mbledhja e Gjyqtarëve mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të VKM-së në datën 18.7.2016 dhe duke i vlerësuar shkaqet e parashtruara në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, arriti në përfundimin se ato nuk janë të përligjura. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim.

*B. Për legjitimimin e kërkesës*

8. Për sa i përket legjitimitetit të unionit, si subjekte iniciuese sipas nenit 134/2 të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre. Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo mbi kërkuuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuarit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimin nr. 60, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Kërkuesi pretendon se përcaktimi i bërë në pikën 9 të kreut II të VKM-së, duke rritur nivelin e tarifës ligjore për licencim, cenon parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike sepse vendos një tarifë joproporcionale dhe në shkelje të rezervës ligjore, që kufizon një të drejtë dhe liri themelore me akt nënligjor dhe jo me ligj, sipas përcaktimit të nenit 17 të Kushtetutës.

10. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata konstaton se USHHSH-ja është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5329, datë 4.5.2016. Anëtarët e unionit janë shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve në Shqipëri. Në statutin e tij parashikohet, ndër të tjera, se qëllimi kryesor është “mbrojtja e interesave të anëtarëve dhe mbështetja e tyre në kryerjen e aktivitetit në fushën e hidrokarbureve”.

11. Për sa më sipër, Gjykata vëren se USHHSH-ja mbron interesat e personave juridikë që

ushtrojnë aktivitet ekonomik në fushën e hidrokarbureve dhe se *prima facie* rezultojnë të dhëna të mjaftueshme se këto interesa preken nga zbatimi i VKM-së. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në këndvështrim të nenit 134/2 të Kushtetutës. Gjithashtu, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse VKM-ja nr. 970/2015 është brenda afatit ligjor 3-vjeçar për t'u kundërshtuar para Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me nenin 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

12. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, sipas nenit 131/c të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është kompetente për të shqyrtuar pajtueshmërinë me Kushtetutën edhe të akteve normative të organeve qendrore dhe vendore. Në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme, prandaj gjatë ushtrimit të kontrollit abstrakt të normës Gjykata ndalet, paraprkishtë, në natyrën e aktit të kundërshtuar, çka lidhet drejtpërdrejt me juridiksionin e saj për shqyrtimin substancial të aktit normativ (*shih vendimin nr. 54, datë 5.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata ka theksuar se një akt me karakter normativ duhet të vendosë norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektsh. Akti normativ është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje, dhe që nuk është shterues në zbatimin e tij, kuptim i dhënë edhe nga ligji nr. 49, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Për sa i përket aktit individual, ai është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Ai i referohet një



fakti konkret, jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike, dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete me natyrë teknike dhe jo normative (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2014; nr. 59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në vlerësimin e Gjykatës, tri janë kriteret që përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në individual ose normativ: i) *subjektet të cilave akti u drejtohet* - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktuar në bazë të karakteristikave të përgjithshme ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; ii) *objekti* - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete e së drejtës administrative ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes me karakter abstrakt; iii) *karakteri shërues/joshterues* - efektet shtrihen te subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njëhershme ose te subjekte të papërcaktuara të së drejtës në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2014; nr. 59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret VKM-ja nr. 970/2015 përcakton procedurat dhe kushtet për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj. Ndër të tjera, në pikën 9 të kreut II të këtij vendimi thuhet: “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5.000.000 (pesë milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 2.000.000 (dy milionë) lekë për bashkitë e tjera*”.

16. Gjykata vëren se VKM-ja nr. 970/2015 i drejtohet të gjithë kategorisë së subjekteve tregtare që veprojnë aktualisht në fushën e hidrokarbureve dhe atyre që do të fillojnë aktivitetin e tyre në të ardhmen. Për këto arsye, Gjykata çmon se nisur nga rrethi i subjekteve që u drejtohet, efektet që do të sjellë mbi to dhe karakteristikat e saj, VKM-ja nr. 970/2015 ka karakter joshterues. Për rrjedhojë, VKM-ja nr. 970/2015 është akt nënligjor normativ⁴ dhe në kuptim të nenit 131/c të Kushtetutës, është brenda juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit kushtetues të lirisë së veprimtarisë ekonomike

17. Kërkuesi pretendon se tarifata e reja të vendosura në pikën 9 të kreut II të VKM-së për licencimin e subjekteve që operojnë në fushën e hidrokarbureve, nuk janë proporcionale, shkelin rezervën ligjore, janë diskriminuese dhe cenojnë parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike.

18. Subjekti i interesuar argumenton se tarifata, përfshirë edhe atë të kontestuar nga kërkuesi, janë pjesë e sistemit financiar të shtetit. Këshilli i Ministrave ka marrë në mënyrë vijuese një sërë nismash rregulluese në sektorin e hidrokarbureve. Të shumta kanë qenë edhe fushatat për të garantuar cilësinë e karburanteve dhe ruajtjen e mjedisit nga pasojat e përdorimit të tyre. Pas gjithë problematikave të hasura në praktikë, u kërkuan dhe u gjetën mjetet e përshtatshme të parashikuara në VKM-në nr. 970/2015.

19. Kushtetuta në nenin 11 parashikon se sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Jurisprudenca kushtetuese është shprehur në mënyrë të vazhdueshme lidhur me kuptimin dhe rëndësinë e lirisë së veprimtarisë ekonomike, duke e përkufizuar atë si e drejta për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, e drejta për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, e drejta për të zgjedhur një punë sipas preferencës, etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë pa asnjë kufizim të qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave. Po ashtu, liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete edhe lirinë e biznesit ose aftësinë për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, lirinë e tregtisë ose mungesën e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, lirinë monetare si masë për të garantuar qëndrueshmërinë e çmimit, lirinë fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lira nga ndërhyrja e shtetit, lirinë e investimit dhe të qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht të kapitalit të huaj, lirinë financiare dhe pavarësinë

⁴ Votoi kundër legjitimitimit Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, zoti Bashkim Dedja



nga kontrolli shtetëror dhe lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Përveç sa më sipër, liria e veprimtarisë ekonomike nënkupton edhe detyrimin e shtetit që nëpërmjet legjislacionit të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike, të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët. Ky detyrim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave dispijlinohet ushtrimi i veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara, me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet, që natyrshëm mund t'i mbartë me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për shkak të rolit aktiv të shtetit, në drejtim të ushtrimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike, hartuesit e Kushtetutës kanë parashikuar kriteret mbi bazën e të cilave mund të ndërhyhet për të rregulluar ushtrimin e kësaj të drejte. Neni 11, paragrafi 3 i Kushtetutës parashikon se “*kufizimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kemi të bëjmë me kriterë që lidhen drejtpërdrejt me një liri konkrete, siç është ajo e veprimtarisë ekonomike. Nisur nga struktura e Kushtetutës, e veçanta e kësaj dispozite është se ajo nuk përfshihet në grupin e të drejtave dhe lirive të tjera, por gjendet e vendosur në pjesën ku parashikohen parimet themelore mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi shtetëror i vendit. Pra, hartuesi i Kushtetutës ka preferuar ta konsiderojë lirinë e veprimtarisë ekonomike, së pari, si parim bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë dhe, së dyti, si pjesë të katalogut të lirive dhe të drejtave të shtetasve. Është pikërisht ky element dallues i kësaj lirie, pra qenia e saj si një nga shtyllat e shtetit demokratik, që i jep kësaj lirie një natyrë të veçantë. Kjo veçanti shprehet edhe në aspektin e parashikimit të kriterit kufizues në të njëjtën dispozitë që duhet të aplikohet në raste konkrete (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Pavarësisht këtij kriteri kufizimi, duke qenë se Gjykata Kushtetuese e shqyrton

pretendimin për cenimin ose jo të kësaj lirie të lidhur ngushtë me sferën e individit, ajo është e detyruar t'i drejtohet edhe përmbajtjes së nenit 17/1 të Kushtetutës, e cila shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në të. Konkretisht, dispozita e nenit 17/1 parashikon se “*kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë*.” Pra, kjo dispozitë, përveç arsyes publike, të cilën e gjejmë edhe te neni 11/3, përmban detyrimin për të respektuar edhe kriterë të tjera, si: kufizimi me anë të ligjit dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë (*shih vendimin nr. 17, datë 27.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, duhet të vihen në balancë interesat e USHSHS-së, nga njëra anë, dhe interesat e shtetit, nga ana tjetër. Për të vlerësuar nëse në këtë rast kushti i baraspeshës është respektuar apo është përmbysur, pra nëse këto subjekte janë ngarkuar me një barrë apo peshë individuale tej masës ose shkallës së duhur, sado i rëndësishëm të jetë interesi publik ose i komunitetit në përgjithësi, Gjykata çmon të nevojshme të vlerësojë nëse strategjia e ndërhyrjes së ligjvënësit respekton kriteret e mëposhtme: i) nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme. Gjykata rithekson se proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh se aspektet e mësipërme nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).



24. Jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, është shprehur se ligjvënësi duhet të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, dobishmërisë dhe proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që si rezultat i tij i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Shpesh reformat radikale vlerësohen si instrumenti që përmbush nevojën për të rritur të ardhurat në buxhetin e shtetit, që krijohet nga të ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera financiare, si dhe prej të ardhurave të tjera të ligjshme. Këto reforma radikale të sistemit ekonomik dhe politik të një vendi ose gjendja e financave të shtetit mund të justifikojnë kufizime të forta të të drejtave themelore të individit, megjithatë rrethana të tilla nuk mund të mbështeten në dëm të parimeve themelore që përshkruajnë Konventën (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen "Strain dhe të tjerë kundër Rumanisë" të datës 30.11.2005*). Edhe për sa i takon hapësirës së vlerësimit që i është dhënë shtetit, sado e konsiderueshme qoftë, ajo nuk mund të jetë e pakufizuar. Ushtrimi i diskrecionit të shtetit, madje edhe në kontekstin e reformave më komplekse, nuk mund të sjellë rrjedhoja në kundërshtim me standardet e Konventës (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen "Maria Atanasin dhe të tjerë kundër Rumanisë", të datës 12.1.2011*).

26. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se ndërhyrja e ligjvënësit në veprimtarinë ekonomike të subjekteve të ndryshme duhet të jetë proporcionale në atë masë që të mos cenojë në thelb gjendjen e tyre

financiare dhe veprimtarinë ekonomike që ato ushtrojnë. Ato, nga ana tjetër, duhet të jenë dhe të arsyeshme, duke vendosur një balancë të drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit për një ekonomi të formalizuar dhe kërkesave të mbrojtjes së lirisë së ushtrimit të veprimtarisë ekonomike dhe të së drejtës së pronës të tatimpaguesve. Për sa kohë normat ligjore nuk sigurojnë baraspeshën e kërkuar mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik, duke vendosur një barrë të tepruar e të papërbalueshme për subjektet tatimpaguese, atëherë ndërhyrja nuk është proporcionale dhe si e tillë sjell cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të së drejtës së pronës (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke ju rikthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se rritja e tarifës së licencimit në masën 20 dhe 50-fish është arbitrare, e paarsyeshme, a paargumentuar dhe joproporcionale. Këshilli i Ministrave nuk arriti të argumentojë pretendimet e tij për domosdoshmërinë e ndërhyrjes në rregullimin e tregut të hidrokarbureve. Ai pranoi se ndërhyrja në fjalë nuk është mbështetur në ndonjë studim paraprak dhe të thelluar, duke u ballafaquar edhe me praktikatat më të mira evropiane. Për këtë arsye, Gjykata çmon se pretendimi se biznesi i hidrokarbureve është zhvilluar në mënyrë të pakontrolluar dhe ka vështirësuar kontrollin e organeve kompetente, është i pabazuar. Përdorimi i mjeteve dhe formave të tilla të papërshtatshme për të "frenuar" konkurrimin e tyre në treg, bie ndesh me parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike. Qeveria duhet të gjejë forma të tjera të përshtatshme, në përputhje me ligjet në fuqi, duke forcuar në mënyrë cilësore punën e organeve të kontrollit, për të shmangur deformimet në treg dhe pasojat negative që mund t'i vijnë interesave të konsumatorëve dhe shtetit.

D. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

28. Kërkuesi pretendon se tarifat e reja të vendosura me VKM-në nr. 970/2015 cenojnë parimin e sigurisë juridike, duke rënduar ndjeshëm situatën e anëtarëve të shoqatës për shkak të shumëfishimit me dhjetëra herë të tarifës së licencës. Të gjithë anëtarët e shoqatës, bazuar në situatën e mëparshme të rregullimit të sistemit të



licencimit, kanë bërë planbizneset e tyre, përfshirë marrjen e kredive bankare, investimet, parashikimin e investimeve të reja etj. Bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, një barrë tatimore e tepruar dhe joproporionale cenon sigurinë juridike dhe konceptin e “parashikueshmërisë”.

29. Gjykata ka theksuar se parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një shtate të favorshme ligjore. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një shtatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese (*shih vendimet nr. 43, datë 6.10.2011; nr. 34, datë 28.5.2012; nr. 37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se tarifa për licencimin e stacioneve të karburanteve, përpara miratimit të VKM-së nr. 970/2015, ka qenë 100.000 (njëqind mijë) lekë. Me miratimin e kësaj VKM-je kjo tarifë u përcaktua në masën 5.000.000 (pesë milionë) lekë për subjektet të cilat operojnë brenda territorit të Bashkisë së Tiranës dhe 2.000.000 (dy milionë) lekë, për subjektet të cilat operojnë në territorin e bashkive e tjera.

31. Siguria juridike është një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës dhe përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një shtate të favorshme ligjore (*shih vendimin nr. 33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitim të tyre (*shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata e çmon të rëndësishme të theksojë se ndryshimi i një shtate ligjore të caktuar nuk duhet bërë në mënyrë arbitrare, pa kritere të qarta apo në kundërshtim me parimin e

shtetit të së drejtës. Çdo ndryshim duhet të vlerësohet edhe në raport me interesat publikë të cilët e kanë detyruar ligjvënësin, në rastin konkret Këshillin e Ministrave, të ndryshojë një shtatë juridike të caktuar. Parimi i sigurisë juridike, në thelb, garanton individin se shteti nuk do të përkeqësojë në mënyrë arbitrare pozitën e tij ligjore, çka do të thotë pa një shkak të bazuar në interesin legjitim publik që mbizotëron. Gjykata thekson se parimi i sigurisë juridike, si standard kushtetues, i zhvilluar nga jurisprudenca e Gjykatës, krahas parimeve të tjera kushtetuese, i imponon ligjvënësit detyrimin për të përcaktuar kritere ligjore të qarta, të qëndrueshme dhe mbi të gjitha joarbitrare.

33. Në rastin në shqyrtim, ligjvënësi ia ka dhënë Këshillit të Ministrave kompetencën për të përcaktuar pagesën për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve. Rritja e kësaj tarife me 50-fish për subjektet të cilat operojnë brenda territorit të Bashkisë së Tiranës dhe 20-fish për subjektet të cilat operojnë në territorin e bashkive e tjera, siç është rasti konkret, përbën një ushtrim arbitrar të veprimtarisë ligjvënëse, që bie në kundërshtim me Kushtetutën. Ndryshimet në aktin nënligjor duhet të kishin sjellë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e së drejtës së fituar, në mënyrë të veçantë të atyre që operojnë në treg dhe ju nevojitet të rinovojnë licencën, mos cenim të besimit dhe pritshmërive legjitime të këtyre subjekteve, të cilat aktualisht e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti. Këto ndryshime, të bëra në mungesë të argumenteve dhe që janë të pajustificuara, nuk garantojnë stabilitet dhe qartësi të mjaftueshme për të shmangur arbitraritetin. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja e Këshillit të Ministrave ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe pretendimi i kërkuarit në lidhje me këtë cenim është i bazuar.

E. Për pretendimin e cenimit të rezervës ligjore

34. Gjykata vëren se kërkuari ka kundërshtuar para saj mënyrën e vendosjes së tarifës, e cila duhet të ishte vendosur me ligj dhe jo me VKM. Kërkuari pretendon se vendosja e kësaj tarife me akt nënligjor bie në kundërshtim nenet 11, 17 dhe 118 të Kushtetutës, duke cenuar kështu rezervën ligjore.

35. Gjykata, gjatë votimit të çështjes për këtë pretendim, për arsye se votat u ndanë në mënyrë të



barabartë, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në këto kushte, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vendosi refuzimin e këtij pretendimi.

Ë. Për pretendimin e cenimit të parimit të diskriminimit

36. Kërkuuesi pretendon se tarifat e licencimit për këtë sektor janë diskriminuese, kurse për sektorët e tjerë janë shumëfish më të ulëta.

37. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuarit Gjykata vlerëson se ai nuk është ngritur në nivel kushtetuese dhe kërkuuesi nuk ka sjellë argumente bindëse për të mbështetur këtë pretendim. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/c dhe 134/1/h të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të pikës 9 të kreut II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar)

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Sipas shumicës, “VKM-ja nr. 970/2015 i drejtohet të gjithë kategorisë së subjekteve tregtare që veprojnë aktualisht në fushën e hidrokarbureve dhe atyre që do të fillojnë aktivitetin e tyre në të ardhmen. Për këto arsye, ajo çmon se nisur nga rrethi i subjekteve që u drejtohet, efektive që do të sjellë mbi to dhe karakteristikeve të saj, VKM-ja nr. 970/2015 ka karakter joshtrues. Për rrjedhojë, VKM-ja nr. 970/2015 është akt nënligjor normativ dhe, në kuptim të nenit 131/c të Kushtetutës, është brenda juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese” (prg. 16 i vendimit). Mbi qëndrimin e shumicës për juridiksionin e Gjykatës në kontrollin e akteve normative nënligjore ndaj qëndrim të kundërt, nisur nga elaborimi i standardit “shterim i mjeteve efektive”, për sa vijon.

3. Neni 131 i Kushtetutës përcakton kompetencat e Gjykatës, ndër të cilat dhe papajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare (131/c). Procedura për shqyrtimin e çështjeve të pajtueshmërisë së ligjit dhe të akteve të tjera normative me Kushtetutën është detajuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Nga ana tjetër, ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative” përcakton kompetencën lëndore të gjykatave administrative lidhur me mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik (neni 7). Ky ligj përcakton edhe kompetencën e gjykatës administrative të apelit, që shqyrtton në shkallë të parë mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative (neni 10).

5. Në çështjen konkrete, kërkuësja, USHSHS-ja, kishte mundësi t’i drejtohej gjykatës administrative të apelit për shfuqizimin e VKM-së, objekt shqyrtimi, por ka zgjedhur t’i drejtohet drejtpërsëdrejti Gjykatës Kushtetuese.



6. Në pamje të parë, në këndvështrimin literal, neni 131 i Kushtetutës nuk kërkon shterimin e mjeteve për subjektet që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për kontrollin abstrakt të akteve nënligjore normative, në ndryshim nga kontrolli i kërkesave të individëve për shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, ku kjo kërkesë është e përcaktuar qartë, (neni 131/f). Megjithatë, vlerësoj se Kushtetuta, si rregull, imponon respektimin e parimit të subsidiaritetit edhe në kontrollin abstrakt të akteve nënligjore, nëse ekziston një mjet tjetër efektiv në sistemin ligjor.

7. Kjo frymë është përqafuar edhe me ndryshimet kushtetuese në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, në nenin 131/f, ku parashikohet se individët mund t'i drejtohen gjykatës, nëse kanë shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave. Kjo dispozitë gjen pasqyrim dhe në ndryshimet e ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, neni 71/a/1, sipas të cilit, kërkuar mund t'i drejtohet Gjykatës kur ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion (me efekt nga 1 mars 2017). Pavarësisht se në kohën e pranimit të kërkesës për shqyrtim dhe gjykimin të çështjes këto dispozita nuk ishin në fuqi dhe akoma nuk prodhojnë efekte pjesërisht, përsëri mendoj se janë një argument i rëndësishëm për ezaurimin e sistemit gjyqësor administrativ për aktet normative nënligjore, para ushtrimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

8. Gjykata administrative, gjatë shqyrtimit gjyqësor të një veprimi administrativ, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos të mos zbatojë një akt nënligjor normativ, në bazë të të cilit është kryer veprimi administrativ që shqyrtohet, kur çmon se akti nënligjor është i paligjshëm (neni 38 i ligjit nr. 49/2012 për gjykimin administrativ). Në këtë mënyrë, gjykatat administrative verifikojnë përputhjen e aktit me ligjin, sipas nenit 118 të Kushtetutës, si gjykatat që janë kompetente për ta bërë një gjë të tillë. Pra, kur ka një organ tjetër gjyqësor që kontrollon aktin nënligjor për sa i përket ligjshmërisë së tij, siç është gjykata administrative e apelit në rastin konkret, ky organ duhet ta bëjë këtë kontroll përpara se çështja të paraqitet në

Gjykatën Kushtetuese. Ky kontroll i ligjshmërisë është mjaft i rëndësishëm, pasi pajtueshmëria e aktit nënligjor me ligjin është një çështje që nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Ushtrimi i kontrollit kushtetues përpara atij administrativ mund të ketë ndikim të papërshtatshëm mbi kontrollin e mëpasshëm që mund të ushtrohet nga gjykata administrative e apelit lidhur me ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ.

9. Nga pikëpamja teorike dhe normative, në thelb, kontrolli i ligjshmërisë ndaj akteve nënligjore normative, që ushtrohet nga Gjykata Administrative e Apelit, është njëkohësisht edhe kontroll i kushtetutshmërisë (nenet 4, 116 dhe 118 të Kushtetutës). Kuptimi normativist bazohet në hierarkinë juridike dhe në supremacinë e normës kushtetuese ndaj akteve më të ulëta, që në doktrinën kushtetuese njihet si parimi i epërsisë (supremacisë) të Kushtetutës. Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, që përbën një parim tjetër të rëndësishëm, atë të kushtetutshmërisë funksionale.

10. Gjyqtari administrativ kur realizon kontrollin e përputhshmërisë së aktit administrativ me ligjin në fakt nuk ndalohet të realizojë edhe kontrollin e kushtetutshmërisë, pasi kushtetutshmëria identifikohet edhe me parimin e hierarkisë së normave të së drejtës (*stricto sensu*), që do të thotë se aktet administrative dhe ligjet duhet të përputhen me normat e Kushtetutës. Në bazë të nenit 145 të Kushtetutës gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin nivel qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Kushtetutshmëria e përfshin ligjshmërinë, pra një akt nënligjor antikushtetues është dhe i paligjshëm, ndërsa e kundërta nuk është gjithmonë e vërtetë, që do të thotë se një akt mund të jetë i paligjshëm, por jo patjetër antikushtetues. Në këtë këndvështrim, parimi i subsidiaritetit nënkupton se kur paraqiten pretendime për paligjshmërinë e një akti nënligjor



jo vetëm që gjykatat administrative duhet të kenë mundësinë të shprehen lidhur me thelbin e aktit, por edhe të bëjnë kontrollin e ligjshmërisë e kushtetutshmërisë së tij, bazuar në parimin e hierarkisë së normave juridike.

11. Kontrolli që bën gjykata administrative është një kontroll efektiv, duke qenë se ajo mund ta shfuqizojë aktin nënligjor nëse vërtetohen shkaqet për ta bërë këtë. Sipas ligjit për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (nr. 49/2012, *i ndryshuar*) gjykata administrative e apelit, kur gjykon si gjykatë e shkallës së parë mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, në vendimin e saj përfundimtar mund të vendosë shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ (*shih nenet 10/b dhe 40/1/a të ligjit nr. 49/2012 të ndryshuar*).

12. Bazuar në konsideratat e mësipërme, pakica vlerëson se kërkesja duhet të kishte shteruar mjetet që kishte në dispozicion para se të ezauronte kontrollin kushtetues të VKM-së nr. 970/2015, në respektim të parimit të subsidiaritetit në kontrollin abstrakt të akteve nënligjore, në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës, për rrjedhojë ajo nuk legjitimohet për këtë kërkim (*ratione materiae*). Së fundmi, dua të theksoj se këtë qëndrim e kam mbajtur edhe në vendimin nr. 60/2016 të Gjykatës Kushtetuese, me kërkuese Dhomën Kombëtare të Avokatisë.

Kryetar: Bashkim Dedja

VENDIM

Nr. 87, datë 30.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 15.9.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 48 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Elis Hyshmeri

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan;

Avokatura e Shtetit.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-3939 (462), datë 23.9.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuetit, që kërkoj pranimin e kërkesës, pretendimet e subjekteve të interesuara, Avokaturës së Shtetit dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkueti Elis Hyshmeri ka ndërtuar në fshatin Labinot-Fushë objektin dykatësh “Bar restaurant motel”, me sipërfaqe ndërtimore 535 m² për çdo kat, mbi truallin me sipërfaqe 3000 m². Kërkueti ka pretenduar se ky ndërtim është realizuar në respektim të ligjit mbi një truall pronë publike të blerë nga komuna Labinot-Fushë, pas përfundimit të procedurave të miratimit dhe zbatimit të lejeve për shesh ndërtimi dhe ndërtimi. Me vendimin nr. 5, datë 20.6.2001, KRRT-ja e komunës Labinot-Fushë ka miratuar lejen për shesh ndërtimi për një kompleks turistik, të përbërë nga një objekt dykatësh së bashku me ambientet ndihmëse, mbi një sipërfaqe trualli pronë publike prej 3000 m² e ndodhur në territorin e juridiksionit të saj. Pas vendimit komuna ka shpallur ankand për arritjen e vlerës më të mirë për shitjen e truallit publik prej 3000 m². Me vendimin nr. 78, datë 26.9.2001, kërkueti është shpallur fitues i ankandit për çmimin 165 lekë m².



2. Në datën 16.11.2007, kërkuesi ka lidhur me komunën Labinot-Fushë një kontratë për shitjen e truallit për ndërtim, me të cilën kjo e fundit i kalon pronësinë mbi sipërfaqen e truallit prej 3000 m². Kërkuesi i është drejtuar subjektit të interesuar ZVRPP-së Elbasan për regjistrimin në pronësi të tij të objektit të ndërtuar dhe sipërfaqen e truallit 3000 m². Me urdhrin nr. 12, datë 6.11.2008 të ZVRPP-së Elbasan i është propozuar kryeregjistruesit refuzimi i regjistrimit të pasurisë së kërkuesit. Subjekti i interesuar, ZQRPP-ja, me urdhrin nr. 1224, datë 12.11.2008, ka vendosur refuzimin e kërkesës për regjistrimin e objektit dhe të truallit me arsyetimin se kontrata e shitblerjes së truallit është lidhur në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve” dhe se sipërfaqja e truallit nuk është në pronësi të komunës Labinot-Fushë, si dhe as nuk ka qenë e regjistruar në emër të kësaj komune përpara shitjes së truallit të kërkuesi.

3. Në këto kushte kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke paditur subjektet e interesuara, ZQRPP-në dhe ZVRPP-në, Elbasan, me kërkesëpadi me objekt anulimin e urdhrit nr. 1224, datë 12.11.2008, nr. prot. 7017/1 të kryeregjistruesit të ZQRPP-së.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4617, datë 28.5.2009, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, anulimin e urdhrit nr. 1224, datë 12.11.2008, nr. prot. 7017/1 të kryeregjistruesit të ZRPP-së Tiranë, detyrimin e ZVRPP-së Elbasan të regjistrojë objektin 2-katësh “Bar restaurant motel”, me sipërfaqe 535 m² për çdo kat ndërtese, si dhe sipërfaqen e truallit prej 3000 m².

5. Mbi ankimin e subjekteve të interesuara, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1389, datë 9.7.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4617, datë 28.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, e cila me vendimin nr. 3117 akti, datë 25.10.2010, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 4617, datë 28.5.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Mbi rekursin e Avokaturës së Shtetit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-3939 (462), datë 23.9.2014,

ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 4617, datë 28.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 1389, datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe rrëzimin e padisë.

II

7. **Kërkuesi Elis Hyshmeri** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-3939 (462), datë 23.9.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë duke argumentuar si vijon:

7.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kolegji ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat dhe duke vendosur në kundërshtim me to.

7.2 Kolegji ka cenuar parimin e sigurisë juridike pasi duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë ka cenuar pronësinë e fituar me vendim të formës së prerë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 3117 akti, datë 25.10.2010, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 4617, datë 28.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, ka paraqitur prapësime me shkrim duke argumentuar si vijon:

8.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar. Gjykata e Lartë ka vepruar në bazë të ligjit, duke shqyrtuar dhe analizuar çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara. Kolegji Administrativ me të drejtë ka konkluduar se kontrata e shitblerjes së truallit është një veprim absolutisht i pavlefshëm, pavlefshmëri të cilën gjykata e konstaton kryesisht në çdo fazë të gjykimit.

8.2 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, nuk është ngritur në nivel kushtetues. Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj dhe kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument për të provuar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.



8.3 Pretendimi për zbatimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit nuk hyn në juridiksionin kushtetues, pasi kontrolli kushtetues është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregull ligjor.

9. **Subjekti i interesuar, ZQRPP-ja**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim.

10. **Subjekti i interesuar, ZVRPP-ja, Elbasan**, ka paraqitur prapësime me shkrim duke argumentuar si vijon:

10.1 ZVRPP-ja, Elbasan ka vendosur refuzimin e regjistrimit të kontratës për shitjen e truallit për ndërtim të lidhur në datën 16.11.2007 midis kërkuarit dhe komunës Labinot-Fushë. Kontrata e lidhur vjen në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, në të cilin përcaktohen rastet e shitjes së trojeve, që janë: ndërtimi i banesave me qëllim lirim të banesave të ish-pronarëve, ndërtimi i banesave nga Enti i Banësive për të pastrehët apo persona të tjerë, si dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për investime. Në rastin konkret leja e ndërtimit është dhënë për ndërtimin e objektit “Bar restorant motel”.

10.2 Komuna Labinot-Fushë e ka shitur pronën duke mos qenë pronare e saj. Kontrata e lidhur është në kundërshtim me nenin 195 të Kodit Civil dhe nuk përbën titull pronësie të detyrueshëm për regjistrim, sepse bie në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

10.3 Miratimi i listës përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që janë transferuar në pronësi të qeverisjes vendore është bërë në vitin 2008, ndërsa kontrata e shitjes është lidhur në datën 16.11.2007. Në nenin 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” përcaktohet se të gjitha pronat, të cilat u kalohen në pronësi njësitë të qeverisjes vendore sipas këtij ligji, do të regjistrohen në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me pronar njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Po kështu do të regjistrohen në kartelën e pasurisë së paluajtshme edhe kushtet dhe kufizimet e vendosura sipas këtij ligji.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

11. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, pasi parashikohet si subjekt nga neni 134/1/g i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata në vijim ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

B. Për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

13. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Sipas kërkuarit, Kolegji ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat dhe duke vendosur në kundërshtim me to.

14. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 2, datë 22.1.2014; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vepron në bazë të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave



administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Në nenin 58 të këtij ligji parashikohet se mund të bëhet rekurs në vetëm kur: a) ligji material nuk është respektuar, është interpretuar ose zbatuar keq apo vendimi i dhënë është në kundërshtim me një vendim të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjyimit; c) ka shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit. Në nenin 63 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në pikën “dh” është parashikuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi shqyrton çështjen në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, vendos ndryshimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të apelit.

16. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjyimit në fakt. Gjykata Kushtetuese thekson se kusht për dhënien e një vendimi për themelin e çështjes nga Gjykata e Lartë, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak

të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në përfundim të gjyimit ka vendosur pranimin e padisë, duke arsyetuar midis të tjerave se “*duke pasur parasysh objektin e padisë që është ligjshmëria e një akti administrativ, në analizën e fakteve dhe atë ligjore të konfliktit objekt gjykimi, do t'i përmbahet vetëm aktit administrativ objekt gjykimi, arsyetimin e këtij akti, qëllimit dhe referencave ligjore të tij, duke mos vënë në diskutim pretendimet që kapërcejnë aktin dhe nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor*”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila në vijim të arsyetimit është shprehur se “*nëse ka pretendime në lidhje me mënyrën e pajisjes së palës paditëse me leje ndërtimi, leje shfrytëzimi apo nëse kontrata e shitblerjes është realizuar në kundërshtim me ligjin, duhet patjetër të mbrohet me një kundërpadi ose padi të re duke i konsideruar veprimet relativisht të pavlefshme apo absolutisht të pavlefshme sipas Kodit Civil, por kurrësi në formën e prapësimeve*”.

18. Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në përfundim të gjyimit, pasi ka rivlerësuar provat e administruara nga gjykatat më të ulëta ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 4617, datë 28.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 1389, datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe rrëzimin e padisë.

19. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka marrë në shqyrtim kontratën e lidhur mes komunës Labinot-Fushë dhe kërkuarit, duke e vlerësuar atë si një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm, që nuk sjell asnjë pasojë juridike të dëshiruar prej palëve. Sipas Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përfundimet e arritura nga gjykatat më të ulëta janë të pabazuara në ligj, pasi për zgjidhjen e drejtë të çështjes ato duhet të mbanin parasysh dispozitat me karakter rregullator mbi vlefshmërinë e veprimit juridik civil të shitjes së sendeve të paluajtshme, kompetencat e njësive të qeverisjes vendore dhe mbi fushën e urbanistikës dhe ndërtimeve.

20. Nisur nga ky arsyetim, Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arritur në konkluzion të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit



Tiranë, duke konstatuar kryesisht pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së datës 16.11.2007 lidhur mes komunës Labinot-Fushë dhe kërkuessit.

21. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë kryesisht nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, konkretisht nëse kontrata e shitjes është lidhur në zbatim të ligjit apo jo, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë rezulton se këto gjykata nuk kanë shqyrtuar vlefshmërinë e kontratës së shitjes.

22. Gjykata vlerëson se nëse Gjykata e Lartë arrin në përfundimin se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse Kolegji Administrativ ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat më të ulëta, atëherë ai duhet t'i prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë për rigjykim çështjen, sipas nenit 63 të ligjit nr. 49/2012. Ai në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj të zhvilluar nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj (*shih vendimin nr. 36, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka tejkaluar kompetencat ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuessit është i bazuar dhe duhet pranuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

24. Kërkuessi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi duke rrëzuar kërkesëpadinë ka cenuar të drejtën e pronësisë të fituar me vendim të formës së prerë. Sipas tij në

harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar duke vendosur në kundërshtim me atë që kanë vendosur gjykatat më të ulëta.

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk mund të vihet në diskutim (*shih vendimet nr. 24, datë 12.11.2008 dhe nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1389, datë 9.7.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4617, datë 28.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-3939 (462), datë 23.9.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 4617, datë 28.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 1389, datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit si dhe rrëzimin e padisë.

27. Pas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkuessi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, e cila, me vendimin nr. 3117 akti, datë 25.10.2010, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 4617, datë 28.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas kërkuessit, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka marrë formë të prerë e si rrjedhim gjykimi i çështjes përbën gjë të gjykuar. Gjithashtu, në parashtrimet shtesë kërkuessi ka paraqitur një vërtetim hipotekor të lëshuar në datën 11.4.2016, sipas të cilit rezulton se në regjistrat hipotekor nr. 42-22, datë 26.10.2015 figuron e regjistruar emër të kërkuessit një sipërfaqe 535 m² dhe një ndërtesë



dykatëshe, bar restorant motel, pa truallin. Në vërtetimin hipotekor regjistruesi ka komentuar se regjistrimi është bërë sipas vendimit nr. 4617, datë 28.5.2009, rezervuar me vendimin nr. 00-2014-3939 (462), datë 23.9.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

28. Në nenin 451 të KPC-së parashikohen rastet kur vendimi merr formë të prerë, të cilat janë kur ndaj tij nuk bëhet ankim; nuk është bërë ankim brenda afateve të parashikuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr; ankesa e paraqitur nuk është pranuar; vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose pushuar gjykimi në shkallë të dytë.

29. Në rastin konkret ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë është ushtruar rekurs, si rrjedhim çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë sipas kërkesave procedurale. Në këtë rast nuk jemi para gjësë së gjykuar, sikurse pretendohet, por në të njëjtin proces gjykimi dhe gjykimi konsiderohet i përfunduar kur merr vendim Gjykata e Lartë, sikurse është rasti konkret. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe rrëzimin e padisë. Bazuar në shkronjën “a” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile vendimi civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk përbën më titull ekzekutiv, pasi duke u vendosur rrëzimi i padisë, nuk përmban detyrim për t’u ekzekutuar.

30. Duke vlerësuar pretendimin e kërkuarit, bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se argumentet e kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e pronësisë së fituar nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

31. Në përfundim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në çështjen në shqyrtim është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f dhe nenit 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajftueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-3939 (462), datë 23.9.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar),
Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari,
Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuar Elis Hyshmeri ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën në lidhje me standardin e sigurisë juridike, ndërkohë jam kundër qëndrimit të mbajtur prej saj lidhur me pretendimin e kërkuarit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj për arsyet në vijim:

2. Në kërkesën e tij, mes të tjerash, kërkuar ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat dhe duke vendosur në kundërshtim me to.

3. Shumica e ka vlerësuar të bazuar pretendimin e mësipërm, duke arsyetuar: “Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka marrë në shqyrtim kontratën e lidhur mes komunës Labinot-Fushë dhe kërkuarit, duke e vlerësuar atë si një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm, që nuk sjell asnjë pasojë juridike të dëshiruara prej palëve. Sipas Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përfundimet e arritura nga gjykatat më të ulëta janë të pabazuara në ligj, pasi për zgjidhjen e drejtë të çështjes ato duhet të mbanin parasysh dispozitat me karakter rregullator mbi vlefshmërinë e veprimit juridik civil të shitjes së sendeve të paluajtshme, kompetencat e njësisë të qeverisjes vendore dhe mbi fushën e urbanistikës dhe ndërtimeve... Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arritur në konkluzion të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, duke konstatuar kryesisht pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së datës 16.11.2007 lidhur mes komunës Labinot-Fushë dhe kërkuarit...Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë kryesisht nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar,



konkretisht nëse kontrata e shitjes është lidhur në zbatim të ligjit apo jo, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë rezultojnë se këto gjykata nuk kanë shqyrtuar vlefshmërinë e kontratës së shitjes”.

4. Për të arritur në përfundimin e mësipërm shumica është bazuar në jurisprudencë kushtetuese tashmë të konsoliduar, sipas së cilës një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 2, datë 22.1.2014; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtësi të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt. Gjykata Kushtetuese thekson se kusht për dhënien e një vendimi për themelin e çështjes nga Gjykata e Lartë, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të

Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Duke e vlerësuar vendimin e Kolegjit Administrativ nën dritën e standardit të mësipërm, mendoj se argumentet mbi të cilat ai ka bazuar vendimmarrjes janë lidhur ngushtësisht me përmbushjen efektive të funksionit të saj si gjykatë e ligjit. Konkretisht, Kolegji Administrativ në vendim arsyeton se “*tjetërsimi i i truallit prej 3000 m² nga komuna Labinot Fushë tek Elis Hyshmeri është realizuar pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8744/2001 dhe përpara nxjerrjes së vendimit nr. 688/2008 të Këshillit të Ministrave që përvaktonte listën e pronave të transferuara në pronësi dhe përdorim për komunën Labinot Fushë*”. Po ashtu, Kolegji shprehet se “*sikurse rezultojnë nga dokumenti “kontratë për shitjen vendasve të truallit për ndërtim”, komuna Labinot Fushë i ka shitur blerësit Elis Hyshmeri truallin prej 3000 m². Kontrata është hartuar nga vetë palët kontraktore dhe është nënshkruar nga të dyja palët. Një noter publik ka vërtetuar nënshkrimin e palëve në kontratë. Pra, është e qartë që nuk kemi të bëjmë me një akt noterial për tjetërsimin e sendit, sikurse e kërkon në mënyrë urdhëruese dispozita e nenit 83 të Kodit Civil*”.

6. Në vështrim të sa më sipër, mendoj se Kolegji Administrativ duke analizuar elementet formale të kontratës ka vepruar brenda kompetencave ligjore, çka të çon në përfundimin se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk ngre dyshime për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

7. Për sa më sipër, vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Elis Hyshmeri është e pabazuar dhe ajo duhet të ishte rrëzuar nga shumica.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 88, datë 30.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo kryesues i Gjykatës Kushtetuese			
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“



Besnik Imeraj anëtar i “ “
 Fatos Lulo anëtar i “ “
 Gani Dizdari anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 27.9.2016 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 53 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Albsig” sh.a.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Pashko Curri, Banka Kombëtare Tregtare sh.a

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 485, datë 4.6.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 816, datë 18.3.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2016-916, datë 7.4.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

Pezullimi i ekzekutimit të vendimeve të mësipërme.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjekteve të interesuara, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton e provuar se shtetasi Pashko Curri në datën 6.8.2009 ka lidhur me shoqërinë “Alb-Siguracion” sh.a. (*Albsig*) kontratën për sigurimin nga zjarri dhe rreziqet shtesë për pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme të një kompleksi turistik në zonën e Shëngjinit, Lezhë, në pronësi të këtij shtetasi. Kontrata ishte e vlefshme për një afat 1-vjeçar.

2. Në datën 30.10.2009 është vërtetuar ngjarja e sigurimit, një zjarr që ka shkatërruar tërësisht pronën e siguruar, dhe subjekti i interesuar i është drejtuar shoqërisë së sigurimit për ta dëmshpërblyer për dëmin e shkaktuar.

3. Shoqëria “Albsig” sh.a., duke pretenduar se nuk është vërtetuar ngjarja e sigurimit e parashikuar në kontratë, pra zjarri aksidental, pasi

sipas saj zjarri ka qenë i qëllimshëm, ka refuzuar pagesën e shumës së pretenduar.

4. Për këto arsye subjekti i interesuar Pashko Curri i është drejtuar me padi gjykatës me objekt detyrimin e shoqërisë “Albsig” sh.a. të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit dhe t’i paguajë atij shumën 28.500.000 lekë për dëmin material të shkaktuar, shumën 3.826.831 lekë si fitim i munguar për 180 ditë, shumën 325.345 lekë si fitim i munguar dhe interesa për periudhën 30.4.2010-11.5.2012, kurse nga data 11.5.2012 deri në likuidimin e detyrimit të paguajë një fitim prej 3.943 lekësh në ditë.

5. Me vendimin nr. 485, datë 4.6.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësit Pashko Curri. Detyrimin e shoqërisë “Alb-Siguracion” sh.a. Tiranë të dëmshpërblejë paditësin Pashko Curri në shumën 32.326.831 (tridhjetë e dy milionë e treqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e një) lekë. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.”*

6. Me vendimin nr. 816, datë 18.3.2014, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

7. Me vendimin nr. 00-2015-623, datë 9.3.2015, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga shoqëria “Albsig” sh.a.

8. Me vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, Gjykata Kushtetuese ka vendosur: *“Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-623, datë 9.3.2015 të Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.”*

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-916, datë 7.4.2016, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit.”*

II

10. **Kërkuesja** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të kërkesës, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

10.1 *Është cenuar e drejta e aksesit* në gjykim. Gjykata e Apelit Shkodër e ka zhvilluar gjykimin në mungesë të kërkuësës (palë e paditur në proces). Po ashtu, kjo gjykatë nuk ka zbardhur në kohë vendimin dhe nuk i ka komunikuar vendimin e plotë të arsyetuar kërkuësës. Për të



kapur afatet kërkuesja ka depozituar rekurs brenda afatit ligjor, megjithëse ky rekurs nuk është depozituar asnjëherë i plotë në kushtet e moskomunikimit të vendimit nga Gjykata e Apelit. Ishte detyrë e administratës gjyqësore të njoftonte kërkuesen dhe t'i komunikonte vendimin, veçanërisht në kushtet kur gjykimi është bërë në mungesë dhe pa dijeninë e saj.

10.2 *Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrim të njëanshëm, duke marrë në shqyrtim vetëm provat e paraqitura nga pala paditëse në gjykim. Gjykatat e faktit nuk janë investuar për të marrë dokumente shkresore ose prova me ekspert, ndonëse ka pasur kërkime në lidhje me këto nga kërkuesja. Ato kanë anashkaluar ekspertimin piroteknik apo thirrjen e një grupi ekspertësh për të provuar dhe marrë një mendim të specializuar për ngjarjen. Gjykatat kanë gabuar edhe në lidhje me vlefshmërinë e provave të marra nga dosja penale, e cila ishte ende nën hetim.

10.3 *Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër ka shqyrtuar si çështjen e themelit, ashtu edhe kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë të kësaj gjykate. Kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues, e cila nuk është pranuar. Megjithatë, pa u arsyetuar vendimi për kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues, kërkesa për pezullim u pushua për mungesë të kërkueses.

10.4 Gjykatat e kanë bazuar vendimin e tyre në fakte e rrethana që nuk rezultojnë nga një vlerësim i drejtë i të gjitha provave në gjykim, si rrjedhojë kanë keqinterpretuar e keqzbatuar dispozitat ligjore. Gjykatat kanë lejuar vazhdimin e gjykimit pa u paguar taksa e padisë, ndërkohë që duhej të kthenin aktet për plotësimin e të metave të padisë. Duke lejuar shkeljet procedurale të paditësit dhe personit të tretë në gjykim, gjykatat janë treguar të njëanshme.

10.5 *Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*. Gjykata e Apelit ka vendosur në pjesën arsyetuese të vendimit të saj të gjithë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka dhënë arsytet se përse shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

10.6 Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh pretendimet e ngritura në rekurs dhe nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, edhe pas vendimit nr. 3/2016 të Gjykatës Kushtetuese që shfuqizoi vendimin e mëparshëm të Kolegjit Civil dhe e ktheu për rigjykim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

11. Gjykata hapi seancën në datën 27.9.2016 dhe konstatoi se kërkuesja, shoqëria “Albsig” sh.a., në datën 20.7.2016 ka paraqitur kërkesë para Gjykatës Kushtetuese për heqjen dorë nga kërkimi i bërë me kërkesën e datës 23.5.2016 me objektin e mësipërm. Shkaku i heqjes dorë, sipas saj, është shlyerja e detyrimit nga subjekti i interesuar.

12. Në datën 12.9.2016, subjekti i interesuar, Pashko Curri, ka paraqitur një kërkesë me të cilën ka konfirmuar zgjidhjen e konfliktit midis tij dhe kërkueses, shoqërisë “Albsig” sh.a., duke bashkëlidhur edhe aktmarrëveshjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

13. Neni 1/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” parashikon: “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.”. Gjykata iu referua nenit 299/b të KPC-së, i cili parashikon se “gjykata vendos pushimin e gjykimit nëse paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë”. Në këto kushte, Gjykata duhet të marrë parasysh kërkimet e palëve dhe të pushojë shqyrtimin e çështjes për shkak të heqjes dorë nga kërkuesja dhe moskëzistencës së mosmarrëveshjes midis palëve.

14. Në kushtet e mësipërme, Gjykata vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të KPC-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe nenin 299/b të KPC-së, njëzëri,



VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryesues), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 89, datë 30.12.2016

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 6.12.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 76 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Fotaq Zaharia

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Pokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Krujë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1/154 akti, datë 10.3.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f, 134/1/i dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

Faqe|27660

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 7, datë 8.2.2011, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës së organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Bashkimin e dënimeve të dhëna me vendimin nr. 33, datë 9.9.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. 27, datë 14.9.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 56, datë 4.11.2010 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë për të dënuarin Fotaq Zaharia në një dënim të vetëm prej 25 vjet burgim...*”. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

2. Gjithashtu, rezulton se në vitin 2009 kërkesi, për shkak të një plage të shkaktuar me armë zjarri, i është nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale, me qëllim fiksimin e fragmenteve kockore me pllakë dhe vida. Pas ndërhyrjes, gjendja e tij shëndetësore është përkeqësuar dhe dëmtimet i kanë shkaktuar humbje të aftësisë së përhershme në masën 70%, dhe pavarësisht trajtimit pranë Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Krujë, gjendja e tij shëndetësore është rënduar. Për pasojë, ai i është drejtuar gjykatës me kërkesë për garantimin e shërbimit të përshtatshëm mjekësor nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) dhe IEVP-ja Krujë dhe ndërprerjen e trajtimit çnjerëzor e degradues si rezultat i mungesës së këtij trajtimi.

3. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 1/154 akti, datë 10.3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe garantimin e shërbimit të përshtatshëm mjekësor nga DPB-ja dhe IEVP-ja Krujë.

II

4. **Kërkesi Fotaq Zaharia** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe ka parashtruar këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

4.1 Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, i formës së prerë, ka ngarkuar DPB-në dhe IEVP-në Krujë të garantojnë shërbimin



mjekësor dhe të realizojnë ndërhyrjen kirurgjikale në këmbën e kërkuarit, siç është konkluduar nga ekspertët mjeko-ligjorë të thirrur gjatë gjyqësorit.

4.2 Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me mungesën e mjeteve apo të pajisjeve mjekësore për të realizuar zbatimin e këtij vendimi. Ekspertët dhe më pas gjykata kanë konkluduar se si pasojë e mungesës së kësaj ndërhyrjeje mjekësore kërkuari trajtohet në mënyrë çnjerëzore dhe degraduese. Gjithashtu, vonesa në zbatimin e vendimit të formës së prerë është e tillë që ka dëmtuar thelbin e së drejtës, moskryerjen e ndërhyrjes kirurgjikale të domosdoshme për gjendjen shëndetësore të kërkuarit.

4.3 Si pasojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë kërkuari ndodhet në gjendje shumë të rëndë shëndetësore. Sipas mjekëve, dëmtimet nervore kryesore të këmbës bëjnë të domosdoshme kryerjen e ndërhyrjes kirurgjikale dhe vazhdimi i situatës do ta përkeqësonte më tepër gjendjen e tij, madje, referuar konkluzioneve të mjekëve, do të zhdukte mundësitë e pakta për rikuperimin e aftësive fizike të humbura.

5. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka parashtruar me shkrim para Gjykatës sa vijon:

5.1 Për sa i përket sjelljes së autoriteteve shtetërore rezulton se që nga viti 2010 kërkuari ka paraqitur në mënyrë të vazhdueshme shqetësimin për mostrajtimin e problemit të tij shëndetësor që është shfaqur gjatë kohës që ndodhej në paraburgim dhe që ka vazhduar edhe gjatë kohës së vuajtjes së dënimit. Lidhur me këtë shqetësim kanë reaguar edhe institucionet shtetërore. Siç del edhe nga aktet që i janë bashkëlidhur kërkesës, organet shtetërore të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë dhe trajtimin e të dënuarve që vuajnë dënimin, përkatësisht Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, IEVP-ja Krujë dhe DPB-ja, kanë bërë të gjitha përpjekjet ligjore të mundshme, brenda kompetencave të tyre për të siguruar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, por trajtimi mjekësor i këtij shtetasi nuk është bërë i mundur jo për shkak të sjelljes së këtyre organeve, por për shkaqe objektive që nuk varen prej tyre.

5.2 Për sa i përket sjelljes së kërkuarit, ai nuk ka qenë bashkëpunues me stafin mjekësor për marrjen përsipër të kryerjes së ndërhyrjes

kirurgjikale, duke pranuar rreziqet konkrete. Përveç pengesës objektive që lidhej me mungesën e materialeve mjekësore për trajtimin mjekësor përkatës të kërkuarit, ka ekzistuar edhe pengesa tjetër objektive që lidhej me respektimin e vullnetit të tij si pacient për këtë ndërhyrje.

5.3 Në kërkesën e paraqitur nuk rezulton ndonjë pretendim konkret që lidhet me mosushtrimin e kompetencave nga ana e Prokurorisë në drejtim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 1/154, datë 10.3.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

6. **Subjekti i interesuar, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë**, ka parashtruar me shkrim para Gjykatës sa vijon:

6.1 Pavarësisht statusit juridik që ka pasur ky subjekt, në procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga kërkuari është shprehur mendimi për pranimin e kërkesës nga gjykata. Po ashtu, nga ana e prokurorisë është nxjerrë urdhri për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të datës 10.4.2015, i cili i është dërguar për zbatim IEVP-së Krujë.

6.2 Nga dispozitivi i vendimit gjyqësor të formës së prerë rezulton se gjykata ka urdhëruar nominalisht DPB-në dhe IEVP-në Krujë për ekzekutimin e këtij vendimi. Të dyja këto institucione kanë qenë të përfaqësuar në gjykim dhe kanë marrë dënimin për vendimin dhe detyrimet që u lindin nga kjo vendimmarrje. Nga dispozitivi i këtij vendimi nuk rezulton që gjykata të ketë urdhëruar ndonjë detyrim për organin e prokurorisë.

7. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, ka parashtruar me shkrim para Gjykatës sa vijon:

7.1 Të dënuarve dhe të paraburgosurve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, u ofrohen dhe përfitojnë pa pagesë të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor. Të gjitha ndërhyrjet kirurgjikale për këta shtetas realizohen në klinikat e kirurgjisë në QSUT-në “Nënë Tereza” dhe SUT-në “Shefqet Ndroqi” dhe jo në sistemin e burgjeve.

7.2 Nga ana e kësaj Drejtorie dhe IEVP-së Krujë është kontaktuar me mjekët për mundësinë e realizimit të ndërhyrjes kirurgjikale. Në datën 11.11.2014 kërkuari është shtruar në Spitalin e Burgut dhe në konsultat e datave 19.11.2014 dhe 20.11.2014 me mjekët specialistë



ortopedë i është rekomanduar realizimi i ndërhyrjes, çka është refuzuar prej tij me pretendimin se nuk mund të operohet me materialet e Spitalit Ushtarak, por ato duhet të sigurohen nga Ministria e Drejtësisë. Në datën 11.5.2015 ai është shtruar sërish në Spitalin e Burgut dhe në konsultën e përgjithshme dhe të zgjeruar në shërbimin e ortopedisë të datës 5.6.2015 i është rekomanduar sërish ndërhyrja kirurgjikale, çka është refuzuar për arsye se kërkohet 100% garanci për rezultatin e saj.

7.3 Kërkuesi është konsultuar disa herë me mjekët ortopedë, të cilët i kanë rekomanduar një ndërhyrje kirurgjikale në Spitalin e Traumës, por ai e ka refuzuar. Në këto kushte, ai nuk mund t'i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale pa miratimin e tij. Nga konsultat e mjekëve specialistë që prej vitit 2011 dhe në vazhdim gjendja shëndetësore e kërkuesit rezulton e njëjtë. Nga ana e institucionit është kontaktuar përsëri me mjekët ortopedë mbi mundësinë e ndërhyrjes, por problemi i vetëm mbetet konfirmimi i pacientit për këtë ndërhyrje. Për sa i përket trajtimit mjekësor, konsultave, ekzaminimeve mjekësore, medikamenteve etj., kërkuesit i ofrohen dhe i sigurohen në çdo kohë dhe sa herë të jetë e nevojshme.

8. **Subjekti i interesuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Krujë**, ka parashtruar me shkrim para Gjykatës sa vijon:

8.1 Me ardhjen në IEVP-në Krujë kërkuesi është trajtuar me shumë kujdes nga personeli shëndetësor i institucionit, i cili kryen shërbim 24-orësh. Atij i janë krijuar të gjitha mundësitë e kushtet për trajtim mjekësor të specializuar, si dhe për kryerjen e të gjitha ekzaminimeve dhe analizave laboratorike të nevojshme për shëndetin e tij. Megjithatë, problemi nuk është zgjidhur përfundimisht për shkak të mospranimit të tij për ndërhyrje kirurgjikale, sepse ka kërkuar garanci 100% për kthimin e këmbës në normalitet, çka nuk i është garantuar nga mjekët, si edhe sepse ka kërkuar materiale cilësore për ndërhyrjen, të cilat nuk disponoheshin në asnjë spital publik apo privat në Shqipëri.

8.2 Në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë kërkuesi është dërguar për shtrim dhe trajtim të specializuar në Spitalin e Burgut në periudhën 11.5.2015-5.6.2016, por ai përsëri nuk ka pranuar të operohet pa marrë garanci për rezultatin e ndërhyrjes. Kërkuesi është vizituar

dhe konsultuar shumë herë nga mjekët specialistë, të cilët kanë konstatuar se dëmtimi i dy nervave kryesore të këmbës së majtë është i parikthyeshëm në masën 70%, çka ka qenë arsyeja pse nuk jepnin garanci për rikthimin e këmbës në normalitet.

8.3 Në kushtet kur kërkuesi ka refuzuar ndërhyrjen kirurgjikale, ajo nuk mund të realizohet pa miratimin e tij.

8.4 Në datën 25.8.2016 ka ardhur kërkesë nga Avokatura e Shtetit për zbatimin e vendimit për masë të përkohshme, të dhënë nga GJEDNJ-ja, dhe shoqërimin e kërkuesit pranë QSUT-së për t'iu nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale. Në zbatim të kësaj kërkesë është bërë kërkesë pranë QSUT-së, që është përgjigjur se pacienti nuk pranon të operohet, sepse kërkon garanci 100%. Pas një kërkesë tjetër për caktimin e datës së ndërhyrjes, ende nuk ka një datë të përcaktuar. Në këto kushte është kërkuar lëshimi nga kërkuesi i një deklarate me shkrim për pranimin e ndërhyrjes, çka është refuzuar prej tij.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin për mosëkzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

9. Kërkuesi pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosëkzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë që ka vendosur që atij t'i garantohet shërbim i përshtatshëm mjekësor për shkak të problemeve shëndetësore të konstatuara gjatë vuajtjes së dënimit me burgim.

10. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimin nr. 24, datë 22.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Ekzekutimi i vendimit konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund



të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Në jurisprudencën konstante të Gjykatës, mbështetur edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, është vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuar, si dhe të autoriteteve përkatëse (*shih vendimin nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për rrjedhojë, për të arritur në konkluzionin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, Gjykata do të ndalet në analizën e secilit prej elementeve të sipërcituara.

i) Kompleksiteti i çështjes

13. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve kanë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, i cili ka përcaktuar detyrimin e institucioneve shtetërore për garantimin e shërbimit të përshtatshëm mjekësor për kërkuar. Për pasojë, kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit.

ii) Sjellja e kërkuar dhe e autoriteteve

15. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuar është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Gjykata ka theksuar se përdorimi nga ana e kërkuar i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij (*shih vendimin nr. 24, datë 22.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kurse në lidhje me sjelljen e debitorit, Gjykata është shprehur se i takon këtij të fundit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 10, datë 1.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate (*shih vendimin nr. 17, datë 23.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se vetëm fakti se autoritetet shtetërore e zbatojnë vendimin pas një vonese thelbësore, nuk mund të konsiderohet se i heq automatikisht kërkuar statusin e personit të cilit i është cenuar një e drejtë, në kuptimin kushtetues. Rrjedhimisht kërkuar mundet ende të pretendojë se është i cenuar në të drejtat e tij të garantuara nga Kushtetuta (*shih vendimin nr. 8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për të vlerësuar sjelljen e kërkuar dhe të institucioneve përkatëse Gjykata duhet të bazohet në aktet shkresore të paraqitura nga palët për qëllime të këtij gjykimi.

18. Sipas këtyre akteve rezulton se pas ndërhyrjes së parë të kryer për kërkuar, për shkak të plagosjes me armë zjarri, ai ka pësuar një rrëzim me pasojë dëmtimin e pllakës metalike të vendosur në këmbë. Pas kësaj ngjarjeje kërkuar ka pretenduar se nuk i është ofruar shërbim mjekësor i përshtatshëm.

19. Në vitin 2010 kërkuar i është drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, duke pretenduar se gjatë qëndrimit në paraburgimin 313 nuk i është ofruar shërbim shëndetësor cilësor, sepse nuk është dërguar për t'u vizituar te një mjek specialist.

20. Me shkresën e datës 25.4.2011, Avokati i Popullit i ka rekomanduar DPB-së që të sigurojë sa më parë materialet mjekësore ortopedike të nevojshme për kryerjen e ndërhyrjes kirurgjikale për kërkuar. Me shkresën e datës 12.5.2011, Avokati i Popullit i ka kthyer përgjigje kërkuar se sipas rekomandimit të stafit mjekësor të Pavijonit të Ortopedisë në Spitalin Ushtarak, ai duhet t'i nënshtrohet një ndërhyrjeje kirurgjikale për të fiksuar pllakën metalike, për kryerjen e të cilës nevojiten materialet mjekësore që mund të gjenden vetëm në spitale apo distributorë privatë



dhe sipas përgjigjes së DPB-së është marrë kontakt me distributorë për të filluar praktikën e blerjes së këtyre materialeve.

21. Me shkresën e datës 23.10.2012, DPB-ja i ka kthyer përgjigje Avokatit të Popullit se 6 materiale të nevojshme për ndërhyrjen nuk gjenden as në depon farmaceutike të këtij institucioni, as në spitalet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe asaj të Mbrojtjes. Për këtë arsye, institucioni është interesuar te distributorët farmaceutikë dhe është mundur të sigurohen vetëm 2 prej tyre. Në këto kushte mjekët specialistë të ortopedisë kanë informuar se nuk mund të kryhet ndërhyrja kirurgjikale.

22. Me shkresën e datës 28.1.2013, Avokati i Popullit i është drejtuar ministrit të Drejtësisë dhe atij të Shëndetësisë, duke i vënë në dijeni se pavarësisht impenjimit të stafit mjekësor, është konstatuar se gjendja mjekësore e kërkuesit vjen duke u përkeqësuar si pasojë e moskryerjes së ndërhyrjes kirurgjikale dhe se mosgjatja në tregun vendas të materialeve të nevojshme për kryerjen e ndërhyrjes nuk justifikon shkëlqen e së drejtës së kërkuesit për të përfituar kujdes shëndetësor nga autoritetet shtetërore, garantuar nga neni 29 i ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”. Për rrjedhojë, ky institucion ka rekomanduar marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e materialeve mjekësore specifike dhe shfrytëzimin e të gjitha mundësive për kryerjen e ndërhyrjes kirurgjikale.

23. Me shkresën e datës 31.7.2013, Avokati i Popullit i është drejtuar Kryeministrit për ta vënë në dijeni për situatën, duke i rekomanduar që të ushtrojë kompetencat e tij ligjore pranë ministrave përkatës për zgjidhjen e rastit të veçantë dhe marrjen e masave të nevojshme.

24. Në datën 23.12.2013, kërkuesi është transferuar për vuajtjen e dënimit në IEVP-në Krujë.

25. Në datën 22.7.2014, kërkuesi ka paraqitur ankesë pranë Ministrisë së Drejtësisë. Kjo e fundit, me shkresën e datës 18.9.2014, ka kërkuar informacion nga DPB-ja për vazhdimësinë e trajtimit shëndetësor që i mundësohet kërkuesit.

26. Me shkresën e datës 4.8.2014, DPB-ja i ka kthyer përgjigje kërkuesit se situata e tij shëndetësore është në kompetencë të mjekëve të Spitalit Ushtarak dhe se ata e kanë sqaruar lidhur me problemet dhe pretendimet e tij.

27. Në datën 30.9.2014, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me kërkesë për garantimin e shërbimit të përshtatshëm mjekësor.

28. Në datën 3.10.2014, kërkuesi i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar që t'i sigurohet ndërhyrja kirurgjikale e nevojshme. Me shkresën e datës 27.10.2014, Ministria e Drejtësisë i ka kthyer përgjigje kërkuesit se sipas konsultave të realizuara me mjekë ortopedë të Spitalit Ushtarak, rasti i tij ka nevojë për procedura kirurgjikale dhe materiale mjekësore specifike, të cilat nuk gjenden në depot farmaceutike dhe në spitalin në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe asaj të Mbrojtjes. Po ashtu, ajo e ka informuar se nga ana e DPB-së ka pasur angazhim maksimal për të siguruar materialet e nevojshme si në sektorin shtetëror, ashtu edhe atë privat, por janë mundur të sigurohen vetëm 2 prej tyre.

29. Me vendimin nr. 1/154 akti, datë 10.3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur pranimin e kërkesës për garantimin e shërbimit të përshtatshëm mjekësor nga DPB-ja dhe IEVP-ja Krujë. Në datën 10.4.2015 prokurori ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal nr. 1/154 akti, datë 10.3.2015.

30. Me shkresën e datës 26.2.2015, Prokuroria e Përgjithshme (e vënë në lëvizje në bazë të ankesës së kërkuesit, i cili ka pretenduar se nuk i ofrohet shërbimi shëndetësor i përshtatshëm) i është drejtuar Prokurorisë së Krujës për informacion. Kjo e fundit, me shkresën e datës 20.4.2015, ka kthyer përgjigje se sipas punonjësve të IEVP-së Krujë ky shtetas ka marrë të gjithë mjekimin e nevojshëm që garanton institucioni, duke i dërguar bashkëlidhur edhe kartelën mjekësore përkatëse.

31. Me shkresën e datës 30.4.2015, Komiteti Shqiptar i Helsinkit i është drejtuar DPB-së për marrjen e masave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

32. Me shkresën e datës 8.6.2015, Komiteti Shqiptar i Helsinkit i është drejtuar kërkuesit Fotaq Zaharia duke e informuar se sipas mjekëve ai vetë ka refuzuar kryerjen e ndërhyrjes, pasi ka kërkuar dhënie garancie 100 %. Në këto kushte ata kanë kërkuar nga kërkuesi që t'i informojë për vendimin e tij përfundimtar për sa i takon ndërhyrjes kirurgjikale të propozuar.

33. Në datën 16.10.2015, Shefi i Shërbimit Ortopedi-Traumatologji i ka paraqitur drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së “Nënë Tereza” (në



bazë të kërkesës së këtij të fundit) informacion lidhur me mjekimin dhe gjendjen shëndetësore të kërkuarit. Sipas këtij informacioni disa nga problemet shëndetësore të pacientit mund të mos shërohen edhe pas ndërhyrjes, por ai është informuar nga mjekët për gjendjen dhe për opsionet e mundshme të ofruara. Po ashtu, ndërhyrja është e komplikuar dhe kërkon një gamë të gjerë pajisjesh dhe mjetesh, por pacienti nuk ka pranuar t'u nënshtrohet ndërhyrjeve të propozuara, të cilat mund të jenë më shumë se një, nëse nuk i jepet garanci suksesi 100%. Nga ana e tyre mjekët janë të gatshëm ta ndihmojnë pacientin nëse ai pranon t'u nënshtrohet ndërhyrjeve dhe nëse kompletohen me gamën e plotë të pajisjeve të domosdoshme.

34. Me shkresën e datës 14.4.2016, IEVP-ja Krujë i ka kthyer përgjigje kërkuarit për masat e marra nga ky institucion në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore.

35. Me shkresën e datës 18.7.2016, Komiteti Shqiptar i Helsinkit i është drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, që në cilësinë e organit epror të kontrollojë procedurat e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga ana e Prokurorisë së Krujës, si dhe problematikën e mosekzekutimit, duke verifikuar, ndër të tjera, edhe saktësinë e protokollit për komunikimin shkresor mes Prokurorisë së Krujës dhe IEVP-së Krujë për dërgimin e urdhrat të ekzekutimit, si dhe mungesën e këtij të fundit në dosjen e çështjes.

36. Në datën 21.7.2016, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

37. Në datën 29.7.2016, kërkuari i është drejtuar GJEDNJ-së me kërkesë për masë të përkohshme.

38. Në datën 25.8.2016, GJEDNJ-ja ka vendosur marrjen e masës së përkohshme, duke kërkuar nga qeveria shqiptare që kërkuarit t'i sigurohet trajtimi i kërkuar mjekësor sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në datën 23.9.2016, kërkuari ka paraqitur në GJEDNJ një ankesë për shkelje të të drejtave themelore të mbrojtura nga KEDNJ-ja.

39. Me shkresën e datës 13.9.2016, IEVP-ja Krujë i është drejtuar drejtorit të Përgjithshëm të

QSUT-së “Nënë Tereza”, që në zbatim të urdhrat të GJEDNJ-së të planifikohet dhe realizohet ndërhyrja kirurgjikale për kërkuarin.

40. Me shkresën e datës 4.10.2016, QSUT-ja “Nënë Tereza” i ka dërguar IEVP-së Krujë përgjigjen e Shërbimit të Ortopedisë të datës 29.9.2016, sipas së cilës pacienti është konsultuar në mënyrë periodike nga stafi mjekësor, sa herë është kërkuar nga ai apo mjekët e DPB-së. Po ashtu, pacienti është sqaruar për gjendjen e tij dhe opsionet e mundshme të ofruara, të cilat janë të dokumentuara në kartelat personale, por ai nuk ka pranuar t'u nënshtrohet ndërhyrjeve (që me gjasa do të jenë më shumë se një), nëse nuk i jepet garanci 100%. Sipas mjekëve ndërhyrjet mund të shërojnë mosngjitjen dhe deri diku shkurtesën e kockës, por në asnjë rast nuk garantohet funksionimi normal i këmbës për shkak të dëmtimeve në të dy nervat kryesorë të anësisë inferiore, të cilët dalin jashtë sferës së kompetencës së këtij shërbimi, duke përbërë objekt trajtimi nga specialistët neurokirurgë. Si përfundim, sipas tyre, me anë të ndërhyrjeve përmirësohet ndjeshëm gjendja e kërkuarit, por nuk garantohet korrigjim i plotë i problemit.

41. Me shkresën e datës 21.10.2016, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit i është drejtuar kërkuarit dhe përfaqësuesit të tij, si dhe IEVP-së Krujë se në zbatim të urdhrat të GJEDNJ-së është kërkuar shoqërimi i menjëhershëm i kërkuarit pranë QSUT-së “Nënë Tereza” për t'iu nënshtrohet trajtimit të nevojshëm mjekësor sipas rekomandimeve të ekspertëve. Nga ana e Drejtorisë së QSUT-së dhe një grup konsulte i përbërë nga 7 mjekë është shprehur gatishmëria për fillimin e ndërhyrjes ndaj kërkuarit sa më shpejt e mundur që të shprehet mendimi me shkrim i kërkuarit nëse është i gatshëm për fillimin e kësaj ndërhyrje. Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar edhe një format i deklarimit për tu firmosur nga kërkuari për këtë qëllim.

42. Me kërkesën e datës 24.10.2016, përfaqësuesi i kërkuarit ka kërkuar informacion në lidhje me faktin nëse janë siguruar materialet që nevojiten për ndërhyrjen dhe nëse nga ndërhyrja që propozohet do të zbatohet plotësisht vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.



43. Me shkresën e datës 1.11.2016, IEVP-ja Krujë ka kthyer përgjigje se kërkuesi ka refuzuar të firmosë deklaratën e vënë në dispozicion dhe se atij i është kërkuar mendim me shkrim, por nuk ka pranuar të shprehet. Pavarësisht kësaj, nga ana e këtij institucioni i është kërkuar QSUT-së “Nënë Tereza” planifikim për ndërhyrjen dhe janë në pritje të konfirmimit të datës.

44. Me shkresat e datave 27.10.2016 dhe 11.11.2016, IEVP-ja Krujë i është drejtuar sërish drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së “Nënë Tereza”, që në zbatim të rekomandimeve të Avokaturës së Shtetit për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së të caktohet sa më shpejt data për ndërhyrjen kirurgjikale.

45. Bazuar në sa më sipër rezulton se që prej dhënies së vendimit gjyqësor të formës së prerë të datës 10.3.2015, kërkuesi u është drejtuar institucioneve përgjegjëse, të cilat, gjithashtu, e kanë informuar në lidhje me gjendjen e tij dhe masat e marra prej tyre. Edhe pse rezulton se kërkuesi vetë ka refuzuar kryerjen e ndërhyrjes kirurgjikale nëse nuk është e suksesshme, ky qëndrim, në vlerësimin e Gjykatës, nuk mund të konsiderohet se është bërë pengesë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, për sa kohë që fillimisht mjekët specialistë e kanë lidhur mosesuksesin e ndërhyrjes me mungesën e materialeve të nevojshme mjekësore, nga të cilat, sipas komunikimeve institucionale, rezulton që të jenë siguruar vetëm 2. Edhe pas marrjes së masës së përkohshme nga ana e GJEDNJ-së dhe kërkimit të paraqitjes së komenteve me shkrim nga subjektet e interesuara për efekte të këtij gjykimi, nga ana e institucioneve përgjegjëse nuk është dhënë asnjë informacion nëse materialet mjekësore të nevojshme janë gjetur tashmë dhe nëse konkluzioni i mjekëve për moskthimin e funksionit normal të këmbës lidhet me mungesën e tyre apo me llojin e problemit shëndetësor të konstatuar.

46. Gjykata është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret

edhe pse institucionet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e kanë njohur detyrimin dhe kanë marrë disa masa për ekzekutimin e tij, ato nuk rezultojnë të kenë qenë efektive. Në këtë kuptim edhe argumenti i paraqitur se është vetë kërkuesi që është bërë pengesë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nuk mund të pranohet, për sa kohë që kryerja e ndërhyrjes/ve kirurgjikale varet nga masat e marra nga institucionet shtetërore për sigurimin e bazës materiale përkatëse të nevojshme.

47. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1/154 akti, datë 10.3.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 420 lekë